



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 495 Akti

Nr. 621 Vendimi  
Tiranë, më 13.2.2023

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Lulzim Hamitaj</b>	Kryesues
<b>Valbona Sanxhaktari</b>	Relatore
<b>Genta Tafa (Bungo)</b>	Anëtare

asistuar nga sekretarja gjyqësore, znj. Jonida Vrana, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot, në datën 10.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, zhvilloi seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Z. Erarbër Madhi**, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;  
**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;  
**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Valbona Sanxhaktari, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi e analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, në pikën 5 të nenit 3 dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.
2. Z. Erarbër Madhi, aktualisht me detyrë gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, është subjekt i rivlerësimit, që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.
3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim Komisioni) në datën 15.6.2020 zhvilloi procedurën e shpërndarjes me short të çështjeve në trupa gjykuese, nga ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Genta Tafa (Bungo), Lulzim Hamitaj dhe Valbona Sanxhaktari. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionerja Valbona Sanxhaktari.
4. Në mbledhjen e datës 18.6.2020 u caktua me mirëkuptim kryesuesi i trupit gjykues, z. Lulzim Hamitaj, u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi.
5. Në referim të pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.
6. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV, “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklaramin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.
7. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V, “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.
8. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI, “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.
9. Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, në Komision janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe

Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ). Këto raporte janë administruar nga relatorja me fillimin e hetimit administrativ.

**10.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, ILDKPKI-ja dërgoi raportin<sup>1</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

**11.** DSIK-ja ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>2</sup> e saj për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi.

**12.** KLGJ-ja ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt rivlerësimi, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar, në zbatim të nenit 43 të ligjit nr. 84/2016, një raport<sup>3</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**13.** Në vijim, relatorja e çështjes ka ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimi i pasurisë; kontrolli i figurës; dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

**14.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 10.10.2022 vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për të tria kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t'u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur prova dhe shpjegime, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

**15.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 11.10.2022, u njoftua mbi të drejtën e tij për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja ose thirrjen e dëshmitarëve lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit u njoh me aktet e dosjes në datën 14.10.2022.

---

<sup>1</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 27.8.2018.

<sup>2</sup> Raport nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.2.2022, të KDZH-së.

<sup>3</sup> Shkresë nr. \*\*\* prot., datë 9.11.2021.

**16.** Në datën 21.10.2022 subjekti ka kërkuar kohë shtesë, kërkesë që iu pranua nga trupi gjykues, duke e shtyrë afatin deri në datën 31.10.2022. Në datën 31.10.2022 subjekti i rivlerësimit ka dërguar shpjegimet e tij dhe i ka kërkuar Komisionit më shumë kohë për të mundësuar një korrespondencë me disa institucione ndërkombëtare lidhur me të ardhura të mundshme dhe punësimin e babait të tij, me qëllim përmbysjen e barrës së provës. Për të mbështetur kërkesën e tij, subjekti i rivlerësimit ka dërguar pranë Komisionit kërkesat e bëra prej tij, dërguar institucioneve përkatëse.

Komisioni e ka pranuar kërkesën e subjektit duke riçelur hetimin gjyqësor, për t'i dhënë mundësi subjektit të gjejë këtë provë të pretenduar prej tij. Në të njëjtën kohë Komisioni ka dërguar kërkesë për informacion drejtuar Ministrisë së Mbrojtjes.

**17.** Trupi gjykues, në datën 17.1.2023, pasi bëri një vlerësim të hapave të ndërmarrë, kohës në dispozicion, informacioneve të ardhura deri në atë moment pranë Komisionit dhe konkludoi se procesi i rivlerësimit është një proces me kohë të limituar, ndaj nuk mund të zgjatet pa afat, për pasojë vendosi të mbyllë hetimin administrativ për subjektin e rivlerësimit Erarbër Madhi, duke i qëndruar rezultateve të hetimit të dërguara në datën 11.10.2022.

**18.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, vlerësoi të vendosë në dispozicion të subjektit të rivlerësimit aktet shkresore që janë disponuar nga Komisioni gjatë kësaj periudhe, si dhe të thërrasë subjektin në seancë<sup>4</sup> dëgjimore pas një periudhe 4-javore, duke e konsideruar këtë si afatin për paraqitjen e çdo prove të re lidhur me pretendimet e tij dhe barrën e provës së Komisionit.

## **II. SEANCA DËGJIMORE**

**19.** Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore publike me njoftimin e bërë elektronikisht me *email* në datën 18.1.2023.

**20.** Seanca dëgjimore me subjektin e rivlerësimit u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, në datën 10.2.2023, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Ferdinando Buatier de Mongeot.

**21.** Subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet dhe opinionin individual në lidhje me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**22.** Z. Erarbër Madhi ka qenë bashkëpunues në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj tij, duke u përgjigjur në kohë, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë të gjithë procedurës së hetimit administrativ.

---

<sup>4</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 17.1.2023.

**23.** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime, kur janë nevojitur, ka qenë korrekt dhe i gatshëm për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

#### **IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**24.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**25.** Referuar vendimit nr. 2/2017<sup>5</sup> të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**26.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetim dhe vlerësim të të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar *Vetting*; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar *Vetting*, të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkrese të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e subjektit, dërguar në Komision; (d) provat shkrese/dokumentet e administruar nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportet e kontrollit të figurës të dorëzuar pranë Komisionit nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar pranë Komisionit nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; si dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

#### **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**27.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë së këtij subjekti. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe burimin e ligjshëm të krijimit të këtyre pasurive.

---

<sup>5</sup> “41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisioneri Publik, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse”.

**28.** Subjekti ka filluar detyrën si stazhier në datën 17.9.2004 në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Fier.

**29.** Në deklaratën *Vetting* (shtojca 2) të dorëzuar në ILDKPKI në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të kanë deklaruar se zotërojnë këto pasuri:

**30. Pasuria automjet tip “\*\*\*\*”,** blerë me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.10.2013, kundrejt shumës 350.000 lekë. Pjesa takuese: 100%.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* shpenzime të ndryshme për mirëmbajtje dhe funksionim normal të automjetit në vlerën 170.000 lekë.

**Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*:** blerë me kursimet personale.

### **Hetimi/analiza ligjore-financiare e kryer nga Komisioni**

**31.** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor konfirmon<sup>6</sup> për Komisionin se automjeti me targa \*\*\* (\*\*\*) është i regjistruar në emër të subjektit të rivlerësimit, duke përcjellë edhe dosjen e mjetit.

### **32. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se:**

a) Automjeti tip “\*\*\*\*”, viti i prodhimit 2004, është blerë nga shtetasi A. P. në Itali prej shtetasit A. A. dhe, sipas deklaratës së shitjes datë 8.4.2013, çmimi i blerjes është 3.000 euro. Paguar në vijim edhe shpenzime doganore<sup>7</sup> në shumën 116.225 lekë, taksa etj.

b) Në datën 31.10.2013 është nënshkruar kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., mes shtetasit A. P. dhe blerësit E. M., kundrejt çmimit 350.000 lekë, deklaruar e likuiduar jashtë zyrës noteriale.

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2013 blerjen e këtij automjeti në vlerën 350.000 lekë, me burim krijimi kursimet nga paga.

**33.** Komisioni e ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me çmimin e blerjes së këtij automjeti, i cili, në përgjigje të pyetësorit datë 24.1.2022, sqaron<sup>8</sup>: *“Në mungesë të dokumenteve, shpenzime të ndryshme që prej fitimit të pronësisë së automjetit për riparime, mirëmbajtjen e funksionimin normal të automjetit janë në vlerën 170.000 lekë. Këto shpenzime janë bërë në kuadër të riparimeve për të cilat kishte nevojë automjeti, i cili pas blerjes kishte rezultuar gjatë përdorimit të tij dhe kontroleve se kishte nevojë për një sërë riparimesh e shërbimesh për qëllim të funksionimit të tij normal. Pra, në thelb, nëse merren në konsideratë këto shpenzime për riparimin e mjetit, rezulton se çmimi i blerjes nga ana ime nuk është nën koston e blerjes nga shitësi”*.

**34.** Duket se shpjegimet e dhëna nga subjekti i rivlerësimit nuk janë në harmoni me ato në deklaratën *Vetting* lidhur me kohën e kryerjes së shpenzimeve në shumën 170.000 lekë.

Nga dokumentacioni i disponuar rezulton se subjekti i rivlerësimit e ka pasur në përdorim këtë automjet pa kundërshtëpërblim për një periudhë kohore 2-mujore përpara nënshkrimit të kontratës së shitblerjes. Në përgjigjet e pyetësorit standard<sup>9</sup> subjekti i rivlerësimit sqaron se gjatë periudhës gusht - tetor të vitit 2013 automjeti në pronësi është përdorur prej tij me qëllim

<sup>6</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020.

<sup>7</sup> Çmimi i referencës i automjetit 581.131 lekë.

<sup>8</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 të pyetësorit datë 24.1.2022.

<sup>9</sup> Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit standard datë 31.8.2020.

verifikimin e kushteve teknike të mjetit. Sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 1.8.2013, të vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, shtetasi A. P., në cilësinë e palës huadhënëse, i jep në përdorim automjetin e tij për një periudhë kohore pa afat dhe pa kundërshtëpërbllim.

**35.** Nga verifikimi i kryer në sistemin TIMS nuk rezultojnë të dhëna që ky automjet të jetë përdorur për udhëtime nga shtetasi A. P. gjatë kohës që e ka pasur në pronësi dhe as nga subjekti i rivlerësimit për periudhën që e ka pasur në përdorim.

**36.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* ndryshimin e targës së automjetit nga \*\*\* në \*\*\*, kryer pas konstatimit të humbjes së targës, deklaruar në datën 26.9.2016 pranë Komisarariatit të Policisë nr. \*\*\* Tiranë.

Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga DPSHTRR-ja rezultojnë<sup>10</sup> se Komisarriati i Policisë nr. \*\*\* Tiranë i ka përcjellë DRSHTRR-së Vlorë vërtetimin për humbjen e targës \*\*\* dhe lejes së drejtim - qarkullimit në emër të subjektit të rivlerësimit. Certifikata e pronësisë me targën e re \*\*\* figuron të jetë lëshuar në datën 21.10.2016 në emër të subjektit të rivlerësimit.

**37.** Komisioni ka pyetur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin A. P. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet<sup>11</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**38.** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit në shumën 350.000 lekë të deklaruar nga subjekti, nga e cila rezultojnë se subjekti i rivlerësimit ka pasur mundësi financiare për blerjen e automjetit. Pra, subjekti ka pasur mundësi financiare për krijimin e gjendjes *cash* të deklaruar në vitin 2012.

**39.** Në përfundim, duke marrë në konsideratë se: (i) çmimi i blerjes i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit duket se është më i ulët se çmimi i tregut për këtë automjet dhe më i ulët se çmimi i blerjes 3 muaj para se të merrej në përdorim nga subjekti; (ii) subjekti i rivlerësimit ka ndryshuar deklarimin e bërë në deklaratën *Vetting*, duke dhënë shpjegime të ndryshme lidhur me shpenzimet e kryera në shumën 170.000 lekë në momentin e blerjes së automjetit për të justifikuar çmimin e blerjes prej 350.000 lekësh – Komisioni i ka kërkuar shpjegime subjektit në lidhje me faktin se çmimi i blerjes i deklaruar prej tij duket se është më i ulët se çmimi i tregut për këtë automjet.

**40.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me konstatimet e mësipërme, dua të sqaroj se, siç kam sqaruar më parë në deklaratën *Vetting*, së bashku me deklarimin e blerjes së këtij automjeti kam deklaruar edhe në zërin shpenzime: ‘Në mungesë të dokumenteve, shpenzime të ndryshme që prej fitimit të pronësisë së automjetit për riparime, mirëmbajtjen e funksionimit normal të automjetit në vlerën 170.000 lekë’. Këto shpenzime janë bërë në kuadër të riparimeve për të cilat kishte nevojë automjeti, i cili, pas blerjes, gjatë përdorimit të tij dhe kontrolleve, kishte rezultuar se kishte nevojë për një sërë riparimesh e shërbimesh për qëllim të funksionimit të tij normal. Pra, në thelb, nëse merren në konsideratë këto shpenzime për riparimin e mjetit, rezultojnë se çmimi i blerjes nga ana ime nuk është nën koston e blerjes nga shitësi.*

*Për më tepër, siç ju kam sqaruar, shtetasi A. P. i cili shiti këtë automjet në periudhën kur sapo kishte blerë këtë automjet nisi fazën e emigrimit të tij përfundimtar drejt Shteteve të Bashkuara*

<sup>10</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020.

<sup>11</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

*të Amerikës dhe në kuadër të procesit të emigrimit nuk kishte më interes në mbajtjen në pronësi të automjetit në Republikën e Shqipërisë e nuk kishte qëllime fitimi në procesin e shitjes”.*

**41.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, duke marrë në konsideratë faktin se: (i) subjekti ka deklaruar shpenzime për këtë automjet në deklaratën *Vetting*; (ii) nuk ngrihen dyshime për fshehje të çmimit të blerjes, pasi diferenca është në një vlerë të vogël; (iii) subjekti ka pasur të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për të blerë automjetin edhe sikur çmimi të ishte ai i blerjes së kryer më herët nga ana e shitësit; (iv) shitësi i këtij automjeti është larguar jashtë Shqipërisë në datën 4.4.2014 – vlerëson se ato janë bindëse.

**42.** Në përfundim, në lidhje me këtë pasuri, konstatohet se subjekti ka kryer deklaram të saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe ka të ardhura të mjaftueshme të ligjshme për blerjen e kësaj pasurie.

### **43. Gjendje *cash* jashtë sistemit bankar**

Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratën *Vetting* kursime në gjendje *cash* jashtë sistemit bankar në vlerën 720.000 lekë.

**Burimi i krijimit sipas deklaratës *Vetting*:** të ardhurat ndër vite.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**44.** Subjekti deklaron kursime si vijon:

- Në DPV-në e vitit 2010 deklaruar kursime nga paga në shumën 230.000 lekë, me burim kursime nga të ardhurat nga paga si gjyqtar, si dhe kursime në gjendjen *cash* në shumën 240.000 lekë, me burim nga të ardhurat nga shitja e dy librave studimorë të shkruar nga ai.
- Në DPV-në e vitit 2011 deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në shumën 350.000 lekë “kursime nga të ardhurat nga paga në gjendje likuiditetesh në vlerën 350.000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2012 deklaruar gjendje likuiditeti *cash* në shumën 250.000 lekë “kursime nga të ardhurat nga paga si gjyqtar në gjendje likuiditetesh në vlerën 250.000 lekë”.
- Në DPV-në e vitit 2013 nuk ka deklaruar shtime apo pakësime të gjendjes *cash*.
- Në DPV-në e vitit 2014 deklaruar kursime nga të ardhurat gjatë periudhës 1.1.2014 – 31.12.2014 në gjendje *cash* në vlerën 350.000 lekë, duke e konsideruar këtë vlerë si shtesë në gjendjen *cash*.
- Në DPV-në e vitit 2015 deklaruar kursime nga të ardhurat gjatë periudhës 1.1.2015 – 31.12.2015 në gjendje *cash* në vlerën 150.000 lekë, duke e konsideruar këtë vlerë si shtesë në gjendjen *cash*.
- Në DPV-në e vitit 2016 deklaruar kursime nga të ardhurat gjatë periudhës 1.1.2016 – 31.12.2016 në gjendje *cash* në vlerën 220.000 lekë, duke e konsideruar këtë vlerë si shtesë në gjendjen *cash*.



**Tabela nr. 1**

<b>Deklarimi i gjendjes cash</b>	<b>2010</b>	<b>2011</b>	<b>2012</b>	<b>2013</b>	<b>2014</b>	<b>2015</b>	<b>31.12.2016</b>	<b>Deklarata Vetting 29.1.2017</b>
<i>Cash me burim të ardhurat e pagës</i>	230.000	350.000	250.000	250.000	600.000	750.000	970.000	<b>720.000</b>
<i>Cash me burim të ardhurat e shitjes së botimeve</i>	240.000	240.000	240.000	240.000	240.000	240.000	240.000	

**45.** Nga vlerësimi i deklarimeve periodike, në harmoni edhe me deklaratën *Vetting*, nuk ka rezultuar i qartë deklarimi lidhur me të ardhurat nga librat, si dhe dinamika e vijimësia e atyre të ardhurave. Po ashtu nuk përputhet shuma e deklaruar ndër vite si likuiditet *cash* me atë të deklaruar në momentin e plotësimit të deklaratës *Vetting* (shihni tabelën).

**46.** Në vlerësim të faktit që pasaktësia në deklarim nuk rezulton të jetë e shoqëruar me mungesë të burimeve të ligjshme të subjektit për krijimin e gjendjes *cash* dhe gjithsesi këto të ardhura nuk janë përdorur për krijimin e ndonjë pasurie pas deklaratës *Vetting*, Komisioni nuk konstatoi problematika.

**47. Vendbanimi i subjektit të rivlerësimit në deklaratën *Vetting***

Subjekti ka deklaruar në deklaratën *Vetting*: “*Shpenzime qiraje mujore në shumën 25.000 lekë për apartamentin me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, në adresën rruga ‘\*\*\*’, pallati \*\*\*, shkalla \*\*\*, kati \*\*\*, ap. \*\*\*, në pronësi të shtetasve B. Gj., E. Gj. dhe I. Gj.*”.

**48.** Subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar adresën e mësipërme si vendqëndrim në DPV-në e vitit 2005 e në vijim. Subjekti ka deklaruar për herë të parë shpenzime qiraje për posedimin e kësaj pasurie në DPV-në e vitit 2016 në vlerën mujore 25.000 lekë dhe vjetore 300.000 lekë.

Nga verifikimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit e ka përdorur këtë pasuri deri në qershor të vitit 2019, pasi më tej ka nisur të banojë në apartamentin e përfutur me trashëgimi pas vdekjes së nënës së tij T. I. (trajtuar në pikat 88-129 në vijim).

**49.** Për të provuar adresën e tij të banimit, subjekti ka depozituar së bashku me pyetësozin standard deklaratat noteriale të lëshuara nga shtetasi N. Gj. në datat 28.10.2016 dhe 28.6.2019. Sipas deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.10.2016, shtetasi N. Gj. deklaroi se apartamentin në bashkëpronësi ia ka lënë me qira subjektit të rivlerësimit për periudhën janar - tetor 2016.

Lidhur me pagesën e shpenzimeve të qirasë, shtetasi N. Gj. deklaroi nëpërmjet deklaratës noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 28.6.2019: “*Apartamentin tonë të mobiluar ne ia kemi lënë me qira shtetasit Erarbër Madhi për periudhën tetor 2016 - qershor 2019. Deklaroj me përgjegjësi të plotë se duke marrë edhe miratimin e bashkëpronarëve të tjerë, unë, në cilësinë e njërit prej bashkëpronarëve, deklaroj me vullnet të lirë dhe të plotë se për periudhën tetor 2016 - qershor 2019 janë shlyer të gjitha detyrimet financiare, qiraja prej 25.000 lekësh në muaj, detyrimet ndaj OSHEE-së dhe UKT-së. Gjithashtu deklaroj se apartamenti më është dorëzuar sot, në datën 28.6.2019, në gjendje të rregullt dhe i mobiluar siç unë ia kisha lënë*”.

**50.** Sipas kartelës së pasurisë<sup>12</sup>, vënë në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit, rezulton se apartamenti i poseduar me qira është regjistruar në datën 6.4.1994 në pronësi të shtetasve N. Gj., E. Gj. dhe I. Gj.

**51.** Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin N. Gj. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet<sup>13</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**52.** Në përfundim nuk konstatohet problematikë në lidhje me këtë marrëdhënie qiraje.

### **53. Në lidhje me të ardhurat nga e drejta e autorit**

Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting*: “*Të ardhura neto nga e drejta e autorit në vitet 2009 - 2010 nga shitja e botimeve në trajtë librash studimorë ‘Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca’ viti i botimit 2008, faqe 292, tirazhi 500 kopje, kosto botimi 65.000 lekë, çmim shitje 1.000 lekë për kopje dhe ‘Kufijtë, punimet e reja dhe posedimi’ viti i botimit 2009, faqe 447, tirazhi 500 kopje, kosto botimi 85.000 lekë, çmimi i shitjes 1.000 lekë për kopje, afërsisht në total 400.000 lekë (shpërndarë në mënyrë personale pranë librarive)*”.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**54.** Lidhur me të ardhurat e përfituara nga shitja e botimeve, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në pyetësin standard<sup>14</sup>: “*Në mënyrë të përafërt në mungesë të faturave tatimore për shkak të shpërndarjes në mënyrë personale pranë librarive dhe periudhës së gjatë kohore që ka kaluar, afërsisht në total 400.000 lekë. Detyrimet tatimore janë likuiduar nga libraritë përkatëse në çastin e shitjes, duke bërë zbritjen në çmim, ku për çdo kopje të shitur zbritet shuma 250 lekë, ndërkohë që nga ana ime si autor i botimeve përfitoj shuma 750 lekë për çdo kopje të shitur nga libraritë ku ishte kryer shpërndarja*”.

**55.** Subjekti, ndër të tjera, i ka bashkëlidhur pyetësorit standard si dokument provues dy fatura, fletëhyrje dhe fletëdalje, për dorëzimin e librave, si vijon:

- fletëhyrje, datë 9.4.2008, për librin “Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca”, sasia 5 copë, me çmim 1.000 lekë, magazinues librari “\*\*\*\*” dhe adresa nga vjen malli emri i subjektit të rivlerësimit;
- fletëdalje, datë 5.4.2008, për librin “Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca”, sasia 5 copë, me çmim 1.000 lekë, me subjektin tregtar “\*\*\*\*” dhe tek adresa nga shkon malli është emri i subjektit të rivlerësimit.

**56.** Në përgjigje të pyetësorit datë 24.1.2022, subjekti i rivlerësimit sqaron<sup>15</sup>: “*Për botimin studimor ‘Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca’, viti i botimit 2008, rezulton se për periudhën përkatëse janë shitur afërsisht 400 kopje. Për botimin studimor ‘Kufijtë, punimet e reja dhe posedimi’, viti i botimit 2009, rezulton se për periudhën përkatëse janë shitur afërsisht 350 kopje. Për sa më sipër sqarova, duke qenë se të gjitha kanë qenë fatura me vlerë më të vogël sesa ajo e nevojshme për ruajtjen e dokumentacionit për efekt deklarimi dhe periudhës*”.

<sup>12</sup> Shihni dokumentet bashkëlidhur pyetësorit standard, datë 31.8.2020.

<sup>13</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

<sup>14</sup> Shihni përgjigjen nr. 6 të pyetësorit standard, datë 31.8.2020.

<sup>15</sup> Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit datë 24.1.2022.

së gjatë kohore që ka kaluar, aktualisht nuk kam asnjë dokumentacion tjetër për të depozituar përveç atij të depozituar së bashku me deklaratën *Vetting*”.

**57.** Komisioni ka kërkuar nga subjekti i rivlerësimit dokumentacion provues mbi shpenzimet e kryera për botimin e këtyre dy librave dhe në përgjigje të pyetësorit datë 24.1.2022 sqaron<sup>16</sup>: “Shpenzimet në lidhje me këto botime janë deklaruar nga ana ime në vlerën 65.000 lekë për botimin studimor ‘Mbrojtja e pronësisë dhe jurisprudenca’, viti i botimit 2008, 292 faqe, tirazhi 500 kopje, që do të thotë në përlogaritje afërsisht 130 lekë kosto e një libri. Shpenzimet në lidhje me këto botime janë deklaruar nga ana ime në vlerën 85.000 lekë për botimin studimor ‘Kufijtë, punimet e reja dhe posedimi’, viti i botimit 2009, 447 faqe, tirazhi 500 kopje, çmimi i shitjes 1.000 lekë, që do të thotë në përlogaritje afërsisht 170 lekë kostoja e një libri”.

**58.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion për të provuar marrëdhënien me shtëpinë botuese për botimin dhe prodhimin e këtyre librave dhe kontratat përkatëse, pagimin e detyrimeve tatimore, si dhe tatimin mbi fitimin.

**59.** Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria Rajonale Tatimore informon ILDKPKI-në<sup>17</sup> se subjekti i rivlerësimit nuk është i regjistruar në organet tatimore për ushtrim aktiviteti privat dhe se në lidhje me të ardhurat e përfituara nga shitja e botimeve të librave nuk disponojnë asnjë dokumentacion.

**60.** Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me çështje të trajtuara me palë shtëpinë botuese “\*\*\*\*” sh.p.k., për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigja<sup>18</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

Në lidhje me këto të ardhura Komisioni nuk i ka përfshirë në analizë financiare, pasi subjekti, pavarësisht se kishte arritur të provonte mbi ekzistencën e librave të shkruara prej tij dhe prodhimin e përdorimin e tyre, nuk kishte mundur të provonte se kishte përfituar të ardhura të cilat përmbushin kriteret e nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, apo se ato ishin prodhuar e shpërndarë në përputhje me legjislacionin në fuqi për botimin dhe shtypjen e librave, si dhe pagesat e detyrimeve tatimore përkatëse si për prodhimin, ashtu edhe mbi të ardhurat e pretenduara të fituara.

**61.** Pas kalimit të barrës së provës subjekti dha të njëjtat shpjegime si edhe gjatë hetimit administrativ, duke pretenduar se ishte përpjekur të provonte të ardhurat nga botimet, si dhe duke qenë se faturat ishin në një vlerë më të vogël se ajo e nevojshme për ruajtjen e dokumentacionit për efekt deklarimi dhe periudhës së gjatë kohore ai nuk disponon asnjë dokumentacion tjetër.

**62.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse. Nga ana e tij nuk është depozituar dokumentacion ligjor për të provuar pagesën e detyrimeve tatimore në lidhje me këto botime, për rrjedhojë ato nuk mund të përfshihen në analizë financiare. Në lidhje me këto të ardhura, duke marrë në konsideratë shumën e tyre, si dhe faktin që nuk janë deklaruar si burim për asnjë pasuri të subjektit në deklaratën *Vetting*, Komisioni vlerëson se impakti i tyre në analizë financiare është i papërfillshëm.

---

<sup>16</sup> Shihni përgjigjen nr. 2 të pyetësorit datë 24.1.2022.

<sup>17</sup> Shihni shkresën e ILDKPKI-së, seksioni \*\*\*\*.

<sup>18</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\*\* prot., datë 28.2.2022.

**63. Subjekti i rivlerësimit deklaron në deklaratën *Vetting*:** të ardhura *neto* në vlerën 2.000 euro, të përfituara nga shitja e autoveturës personale tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1999, nëpërmjet kontratës së shitjes së automjetit datë 26.4.2014. Pronësia e këtij automjeti është fituar sipas kontratës së blerjes datë 12.7.2010, në shumën 400.000 lekë.

**64.** Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimeve të Transportit Rrugor konfirmon për Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur në pronësi automjetin me targa \*\*\*, duke përcjellë edhe dosjen e mjetit.

**65.** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të DPSHTRR-së rezulton se automjeti tip “\*\*\*\*”, vit prodhimi 1999, është blerë nga subjekti i rivlerësimit nëpërmjet kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.7.2010, në vlerën 400.000 lekë. Me kontratën nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.4.2014, subjekti i rivlerësimit e ka shitur këtë automjet në vlerën 2.000 euro (280.220 lekë).

**66.** Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me çështje të trajtuara me shtetasit D. M. dhe R. K. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet<sup>19</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**67.** Komisioni ka përgatitur analizën financiare për blerjen e automjetit, duke marrë në konsideratë të ardhurat/shpenzimet për periudhën janar 2010 - prill 2010, nga e cila rezulton se subjekti i rivlerësimit është në pamundësi financiare për blerjen e automjetit në vlerën - 231.131 lekë. Në këtë analizë nuk janë marrë në konsideratë të ardhurat e deklaruara nga subjekti mbi shitjet nga librat e botuar prej tij si autor, për sa kohë nuk është provuar e dokumentuar shitja, si dhe pagimi i taksave e tatimeve përkatëse. Si rrjedhojë e këtij konstatimi, të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit nuk mund të konsiderohen të ardhura të ligjshme e të përfshihen në analizën financiare për vitin 2014.

**68.** Në lidhje me këtë rezultat negativ subjektit iu kërkuan shpjegime.

**69.** Subjekti, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, sqaroi se në analizë financiare duhej të përfshiheshin të ardhurat nga botimet si dhe ai çdo vit kishte kursyer një shumë nga 80.000 lekë deri në 120.000 lekë, e cila nuk është pasqyruar në deklaratat përkatëse për shkak të mosnjohjes siç duhet të pasqyrimin të kursimeve *cash* në këto deklarata.

**70.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato nuk janë bindëse dhe nuk mbështeten në dokumentacion provues. Subjekti ka deklaruar rregullisht gjendjen *cash*/kursimet *cash* të tij, sipas së cilës Komisioni ka konstatuar një anomali në deklarin *cash* të tij ndër vite me atë *Vetting* në shumën 250.000 lekë. Kjo shumë hipotetikusht mund të ketë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie dhe do të mbahet në konsideratë nga Komisioni në vlerësimin tërësor të pasurisë në kuadër të parimit të proporcionalitetit.

Në përfundim, për sa kohë nga ana e subjektit nuk janë deklaruar pakësimet *cash*, si dhe është pretenduar se si burim kanë shërbyer edhe të ardhurat nga botimet e librave, Komisioni vlerëson se subjekti gjendet në kushtet e pamjaftueshmërisë për blerjen e automjetit në analizë në shumën 231.131 lekë, e cila nuk mund të shërbejë si shkak autonom për marrjen e masës disiplinore ndaj subjektit të rivlerësimit.

**71. Kartë krediti “\*\*\*\*” në BKT,** në emrin personal të subjektit, me limit përdorimi 85.000 lekë, me datë aktivizimi 8.4.2014.

---

<sup>19</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2022.

**72.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për herë të parë në DPV-në e vitit 2014 aktivizimin e kartës së kreditit “\*\*\*”, me limit përdorimi 85.000 lekë. Subjekti ka deklaruar në DPV-në e viteve 2015 - 2017 se karta e kreditit nuk është përdorur gjatë vitit.

**73.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DPV-në e vitit 2018 çaktivizimin dhe mbylljen në datën 23.10.2018 të kartës së kreditit “\*\*\*”, me limit përdorimi 85.000 lekë, e papërdorur.

BKT-ja ka konfirmuar<sup>20</sup> për Komisionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur kartë krediti me limit përdorimi 85.000 lekë, datë aprovimi 3.6.2014, e cila nuk është përdorur.

**74.** Në përfundim nuk rezultuan problematika dhe se deklarimi i subjektit të rivlerësimit përputhet me dokumentacionin e administruar gjatë hetimit administrativ.

**75.** Nga analiza financiare e kryer, subjekti rezulton në pamundësi financiare për periudhën e rivlerësimit vetëm në vitin 2010 në shumën -313.323 lekë për krijimin e pasurive dhe mbulimin e shpenzimeve me të ardhura të ligjshme nga paga.

**76.** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti pretendoi se në analizë duhej të përfshiheshin të ardhurat nga botimet.

**77.** Komisioni, në lidhje me këtë pretendim të subjektit, është shprehur në pikën 62 të këtij vendimi, për rrjedhojë ai rezulton me një pamjaftueshmëri financiare në shumën 313.323 lekë, e cila në vetvete nuk përbën shkak të mjaftueshëm për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit.

## **GJETJE TË TJERA**

### **Vendbanim i deklaruar nga subjekti i rivlerësimit ndër vite**

**78.** Subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në përgjigje të pyetësorit standard<sup>21</sup> se për shkak të ushtrimit të detyrës si gjyqtar në qytetin e Vlorës ka disponuar për periudhën shtator 2007 – korrik 2013 një apartament me qira me sip. 28 m<sup>2</sup>, në qytetin e Vlorës, me pagesë 10.000 lekë/muaj, në pronësi të shtetasit Ç. H.

**79.** Subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, i ka bashkëlidhur pyetësorit standard aktmarrëveshjen datë 5.9.2007, me palë qiradhënëse shtetasin Ç. H., me afat kohor 1-vjeçar dhe qira mujore 10.000 lekë.

**80.** Komisioni ka kryer verifikimin në sistemin *online* të ASHK-së, nga ku rezulton se në pronësi të shtetasit Ç. H. figuron edhe një apartament me strukturë 1+1 në qytetin e Vlorës, i përfituar nëpërmjet degës rajonale të EKB-së Vlorë.

**81.** Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë lidhur me çështje të trajtuara me shtetasin Ç. H. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjja<sup>22</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**82.** Komisioni ka vlerësuar të përfshijë në analizën financiare për periudhën 2004 – shtator 2007 shpenzime udhëtimi për në vendin e punës, si dhe për periudhën shtator 2007 – korrik 2013 shpenzime qiraje në shumën 10.000 lekë/muaj (për më shumë detaje referojuni analizës financiare vjetore).

<sup>20</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020.

<sup>21</sup> Shihni përgjigjen nr. 1 të pyetësorit standard, datë 31.8.2020.

<sup>22</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

### **83. Apartament 1+1 me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”**

Komisioni ka kërkuar nga Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Veri<sup>23</sup> dokumentacionin tekniko-ligjor për këtë pasuri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të përcjellë nga ASHK Tiranë Veri rezulton se:

**a)** Shtetasi A. M., babai i subjektit të rivlerësimit, ka nënshkruar në datën 20.4.1995 kontratën e shitblerjes me palë ish-Ndërmarrjen Komunale të Banesave për apartamentin me strukturë 1+1, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”. Vlera e privatizimit prej 7.861 lekësh është paguar menjëherë me mandatarkëtimin nr. \*\*\*, datë 18.12.1993.

**b)** Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 15.7.2005, ka pranuar me kërkesë të subjektit të rivlerësimit lëshimin e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin A. M., duke përcaktuar si trashëgimtarë të vetëm ligjorë shtetasen T. M. (nëna e subjektit) dhe subjektin e rivlerësimit.

Sipas certifikatës së pronësisë datë 29.5.2005, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasës T. M., me pjesë takuese  $\frac{3}{4}$  dhe subjektit të rivlerësimit me pjesë takuese  $\frac{1}{4}$ .

**84.** Subjekti i rivlerësimit nuk ka pretenduar përfitimin e pjesës takuese të të ardhurave nga shitja e kësaj pasurie dhe as përdorimin e tyre si burim për krijimin e ndonjë pasurie.

**85.** Nga hetimi ka rezultuar se pas plotësimit dhe dorëzimit të deklaratës *Vetting* subjekti ka përfituar me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2019, të trashëgimlënëses T. I. (nëna e subjektit të rivlerësimit), përveç të tjerave, dy pasuri, përkatësisht:

**i) Pasuria apartament me sip. 124.7 m<sup>2</sup>**, me vendndodhje në Tiranë, Njësia Administrative Nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, ndërtesa nr. \*\*\*, hyrja \*\*\*, në emër të subjektit të rivlerësimit. Ky apartament është prej qershorit të vitit 2019 vendbanimi i subjektit të rivlerësimit.

**ii) Bono thesari** të investuara në datën 5.1.2009 në shumën 4.000.000 lekë, me afat 1-vjeçar, shtuar në datën 29.12.2009 në shumën 4.500.000 lekë dhe rinovuar çdo vit deri në datën 6.1.2020 kur është maturuar ky investim në vlerën 4.490.961 lekë.

**86.** Këto pasuri nuk janë pjesë e deklaratës *Vetting* dhe nuk janë deklaruar nga subjekti, pasi kanë qenë pasuri të regjistruara në emër të nënës së tij, e cila nuk është konsideruar prej tij si person i lidhur apo person tjetër i lidhur.

**87.** Komisioni është informuar lidhur me këto pasuri për shkak të hetimit dhe ka vlerësuar të hetojë më tej për burimin e tyre, pasi: (i) janë krijuar përkatësisht në vitet 2012 dhe 2009 nga nëna e subjektit, znj. T. I.; (ii) pas vdekjes së saj kanë kaluar në pronësi të subjektit të rivlerësimit; (iii) subjekti është trashëgimtari i vetëm i pasurive të nënës së tij.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**88.** Në lidhje me apartamentin me sip. 124.7 m<sup>2</sup>, Drejtoria Vendore e ASHK-së Tirana Jug<sup>24</sup> ka përcjellë dokumentacionin e disponuar lidhur me këtë pasuri. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ASHK-së rezulton se:

<sup>23</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2022.

<sup>24</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2022.

- i. Pasuria apartament me sip. 124.7 m<sup>2</sup> është regjistruar në emër të shtetasve S. H. dhe Z. H., blerë me çmimin 1.900.000 lekë në vitin 2000. Pasuria është rivlerësuar nga z. S. H. në datën 9.4.2012 për vlerën 16.776.450 lekë dhe është paguar detyrimi tatimor me mandatarëtimin datë 9.4.2012, të “Credins Bank”, në vlerën 148.765 lekë.
- ii. Nëpërmjet kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2012, shtetasit S. H. dhe Z. H. i kanë shitur nënës së subjektit të rivlerësimit, znj. T. I., këtë pasuri sipas çmimit të rivlerësimit prej 16.776.450 lekësh, e likuiduar *cash* në zyrën noteriale nga blerësja tek shitësit, e cila më pas është regjistruar në pronësi të saj në datën 23.4.2012.
- iii. Znj. T. I. ka ndërruar jetë në datën 18.4.2019 dhe me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2019, është përcaktuar subjekti si trashëgimtari i vetëm ligjor i të gjithë pasurive të trashëgimlënësës T. I. e në vijim është bërë edhe regjistrimi në datën 1.7.2019 i pasurisë në emër të subjektit të rivlerësimit.

**89.** Komisioni ka pyetur Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë lidhur me çështje gjyqësore të trajtuara nga gjyqtari Erarbër Madhi me shtetasit S. H. dhe Z. H. për raste të mundshme të konfliktit të interesit dhe nga përgjigjet<sup>25</sup> nuk ka rezultuar ndonjë e dhënë.

**90.** OSHEE-ja konfirmon<sup>26</sup> për Komisionin se në emër të shtetasës T. I. figuron kontratë furnizimi dhe se nga boksi i faturimeve rezulton se nga qershori i vitit 2012 deri në prill të vitit 2019 është paguar tarifa bazë/fikse pa konsum.

**91.** UKT-ja konfirmon për Komisioni<sup>27</sup> se në emër të shtetasës T. I. figuron kontratë furnizimi me status “aktiv” në kategorinë e konsumatorëve familjarë, me detyrime të likuiduara deri në korrik të vitit 2020.

**92.** Nga verifikimi i të dhënave nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile<sup>28</sup> rezulton se shtetasja T. I., e datëlindjes 29.11.1949, ka qenë në përbërje familjare me subjektin e rivlerësimit për periudhën 2005 – 18.4.2012. Pasuria apartament banimi në Tiranë është blerë në datën 14.4.2012 nga nëna e subjektit (në momentin e blerjes ajo ka qenë 63 vjeçe), kohë në të cilën subjekti ka rezultuar në një certifikatë familjare me nënën. Nëna e subjektit të rivlerësimit është shkëputur nga certifikata familjare me të birin, duke kaluar në vijim në certifikatë të veçantë me statusin “kryefamiljare” nga data 18.4.2012.

**93.** Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit për të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasuri, i cili nuk ka paraqitur informacion dhe të dhëna, duke kërkuar që nëna e tij të mos konsiderohej person i lidhur apo person tjetër i lidhur me subjektin.

Në përgjigje të pyetësorit datë 20.1.2022, subjekti i rivlerësimit sqaron<sup>29</sup>: *“Midis meje dhe nënës time, apo çdo pjesëtar tjetër të familjes sime të origjinës, nuk ekziston asnjë interes pasuror apo çdo marrëdhënie biznesi në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si në formën e një transaksioni financiar, kontratë dhurimi, huadhënieje, huamarrjeje apo çdo veprimi tjetër juridik të çfarëdoshëm. Me vdekjen e saj në datën 17.4.2019, me kushtet kur ajo nuk është*

<sup>25</sup> Shihni shkresat nr. \*\*\* prot., datë 10.2.2022 dhe nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

<sup>26</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.9.2020.

<sup>27</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.9.2020.

<sup>28</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.6.2022.

<sup>29</sup> Shihni përgjigjen e pyetësorit datë 24.1.2022.

*thirrur asnjëherë për të deklaruar në lidhje me pasurinë e saj dhe as si person i lidhur gjatë gjithë gjallërisë së saj, vlerësoj se nuk mund të më ngarkohet barra e provës për të provuar pasurinë e të ndjerës... Në këtë kuptim, me sa jam në dijeni, pasuria në fjalë e llojit apartament me sipërfaqe 124.27 m<sup>2</sup> është blerë me kursimet e gjithë jetës së babait dhe nënës time (i cili pas vdekjes të gjitha kursimet e krijuara gjatë gjithë jetesës së tyre të përbashkët ia la nënës sime).*

*Në këto kushte, duke qenë se nëna ime e ndjerë ka ndërruar jetë në datën 17.4.2019, e kam të pamundur të gjej dokumentacion, duke qenë se ajo nuk është më gjallë dhe nuk mund të më japë referime lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë së saj”.*

**94.** Në lidhje me bonot e thesarit, nga shkresa e Bankës së Shqipërisë<sup>30</sup> ka rezultuar se shtetasja T. I. ka investuar në bono thesari në datën 5.1.2009, në shumën 4.000.000 lekë, me afat 1-vjeçar, e cila është shtuar në datën 29.12.2009 në shumën 4.500.000 lekë dhe është rinovuar çdo vit deri në datën 6.1.2020 kur është maturuar ky investim në vlerën 4.490.961 lekë. Interesat e krijuar nga ky investim janë tërhequr çdo muaj prej shtetasës T. I.

**95.** Në periudhën e investimit në bono thesari në vitin 2009 rezulton se shtetasja T. I. ka qenë në përbërje familjare me subjektin e rivlerësimit, sipas konfirmimit të Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile<sup>31</sup>.

**96.** Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit mbi burimin e të ardhurave të nënës së tij për krijimin e kësaj pasurie, i cili, në përgjigje të pyetësorit datë 24.1.2022, sqaron: *“Unë si subjekt rivlerësimi ndodhem në situatën e qartë të një regjimi pasuror të ndarë me anëtarët e tjerë të familjes dhe në situatën ku nuk kam kontribuar asnjëherë në krijimin e pasurisë në trajtë likuiditetesh në pronësi të nënës time të ndjerë, pasi midis meje dhe të ndjerës asnjëherë nuk janë kryer transaksione të asnjë lloji dhe asnjëherë nuk kam kontribuar për pasurinë e saj dhe as përdorur apo përfituar nga kjo pasuri në asnjë rrethanë. Në këtë kuptim, me sa jam në dijeni, pasuria në fjalë e llojit likuiditete është pjesë e pasurisë personale të prindit të ndjerë, krijuar me kursimet e gjithë jetës të babait dhe nënës time, i cili pas vdekjes të gjitha kursimet e krijuara gjatë gjithë jetesës së tyre të përbashkët ia la nënës sime”.*

**97.** Duke qenë se Komisioni ka ngritur dyshime për pasuri të fshehura të subjektit, ka vijuar hetimin për burimin e ligjshëm të të ardhurave.

**98.** Nga hetimi në lidhje me të ardhurat e nënës së subjektit, ka rezultuar se:

- i. ISSH-ja informon<sup>32</sup> Komisionin se të dhënat e disponuara për shtetasen T. I. janë nga viti 2012. Sipas këtyre të dhënave rezulton se kjo shtetase nuk ka përfituar të ardhura nga pagat, për të cilat mund të ishin paguar kontributet e sigurimeve shoqërore/shëndetësore dhe se ajo ka përfituar për periudhën qershor 2015 – dhjetor 2018 pension familjar me masë mujore përfundimtare 15.346 pagë *bruto* dhe pension familjar suplementar me masë mujore 6.689 pagë *bruto*.

<sup>30</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020.

<sup>31</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 2.6.2022.

<sup>32</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 7.2.2022.



- ii. Dega e Arkivit Rajonal Tiranë informon<sup>33</sup> Komisionin se nuk mund të konfirmojë periudhat kontributive për shkak të të dhënave të pamjaftueshme (nuk mjafton si e dhënë vetëm emri i nënës së subjektit, por duhet edhe punëdhënësi apo të dhëna të tjera).
- iii. Nëna e subjektit, znj. T. I., ka përfituar në vitin 2005 të ardhura nga shitja e apartamentit me sip. 53 m<sup>2</sup>, në shumën 1.200.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2005 (¾ pjesë takuese e vlerës së shitjes së pasurisë prej 1.600.000 lekësh). Në lidhje me shumën 1.600.000 lekë, subjekti nuk e ka pretenduar si të përfituar nga ana e tij (shihni pikat 83-84 të këtij vendimi).
- iv. Nëna e subjektit të rivlerësimit ka pasur procese gjyqësore me palë paditëse vëllain e saj lidhur me një shtëpi private në bashkëpronësi të trashëguar prej prindërve të saj, nga e cila duket se nuk e ka poseduar fizikisht dhe se ka përfituar shpërblim për përdorimin e sendit në shumën 11.000 lekë/muaj, sipas vendimit të gjykatës së shkallës së parë nr. \*\*\* (përfunduar më 8.5.2014 nga Gjykata e Lartë), me debitor shtetasin A. I.
- v. Nëna e subjektit ka investuar në blerje bonosh thesari në Bankën e Shqipërisë në shumën fillestare 4.000.000 lekë, në datën 5.1.2009, dhe ka përfituar interesa *neto* deri në vitin 2012 në shumën 883.158 lekë e më vonë interesat kanë kaluar në llogarinë e saj bankare. Këto bono thesari kanë vijuar deri në vitin 2019 (kur ajo ka ndërruar jetë) dhe ajo ka tërhequr vetëm interesat e përfituar nga maturimi i tyre ndër vite, duke e lënë të paprekur shumën 4.000.000 lekë.
- vi. Nëna e subjektit ka çelur për herë të parë llogari bankare në BKT në datën 19.6.2014, për kalimin e interesave nga maturimi i bonove të thesarit dhe në “Raiffeisen Bank” në datën 23.3.2015, për kalimin e shumave për qiratë sipas vendimit gjyqësor. Ajo ka deklaruar në formularët e bankës se është me profesion arsimtare.

**99.** Lidhur me të ardhurat e krijuara nga babai i subjektit deri në vitin 2005, nga hetimi ka rezultuar se:

- i. “Raiffeisen Bank” ka informuar<sup>34</sup> Komisionin se shtetasi A. M. ka pasur llogari page të çelur në maj të vitit 2005, në të cilën janë kredituar të ardhura nga pagat për 3 muaj, në shumën totale 34.002 lekë.
- ii. Arkivi ISSH Lundër ka informuar<sup>35</sup> Komisionin se shtetasi A. M.:
  - a. ka qenë i punësuar pranë Repartit Ushtarak 12000 - Katedra e Kimisë për periudhat janar – dhjetor 1974, janar 1987 – dhjetor 1990 dhe qershor 1992 – tetor 1992;
  - b. ka qenë i punësuar pranë Ministrisë së Mbrojtjes për periudhat korrik 1997 – dhjetor 2000, janar 2001 – dhjetor 2004 dhe janar – korrik 2005;
  - c. nga të dhënat e dokumentuara rezultoi se shtetasi A. M. për periudhën 1997 –2005 ka përfituar të ardhura nga paga *neto* në shumën 1.898.399 lekë. Një pjesë e tyre duhet të jetë konsumuar për shpenzimet jetësore të familjes.
- iii. Ministria e Mbrojtjes ka informuar Komisionin se shtetasi A. M. ka shërbyer si ushtarak aktiv në detyra të ndryshme për periudhën 1964 – 2002 dhe ka bërë me dije se lidhur me angazhimin në aktivitete/projekte si NATO/OPCW, etj., ai nuk është trajtuar financiarisht

<sup>33</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 11.2.2022.

<sup>34</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 28.9.2022.

<sup>35</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.9.2022.

nga strukturat e kësaj Ministrie. Ai mund të jetë trajtuar nga strukturat e NATO-s dhe organizatat e angazhuara, të cilat nuk kanë informacion lidhur me pagesat e përfituara. Gjithashtu ato kanë përcjellë disa diploma/certifikata angazhimesh në këto institucione ndërkombëtare, të cilat janë për periudha të shkurtra kohore 1998 – 2000.

- iv. Nga dokumentacioni i paraqitur nga subjekti lidhur me pasaportën e babait të tij, vihet re një numër i konsiderueshëm udhëtimesh deri në vitin 2005.
- v. Nga dokumentacioni i administruar gjatë hetimit ka rezultuar se babai i subjektit, z. A. M., i datëlindjes 19.12.1946, ka ndërruar jetë në datën 21.5.2005. Në vitin 2005 është çelur trashëgimia ligjore. E vetmja e dhënë që rezulton është një shtëpi banimi e përfituar në origjinën e saj me privatizim, e cila është shitur më tej nga bashkëshortja e tij dhe subjekti i rivlerësimit më 22.9.2005, për shumën 1.600.000 lekë, si dhe një llogari bankare page në “Raiffeisen Bank” me një shumë prej 73.000 lekësh.

**100.** Komisioni ka kërkuar në vijimësi nga subjekti i rivlerësimit informacion shterues lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të nënës së tij dhe në përgjigjet e pyetësorit datë 4.4.2022 ka shpjeguar se si burim kanë shërbyer kursimet familjare nga të ardhurat e punës së babait A. M. Në përgjigjet e pyetësorit datë 19.4.2022, subjekti i rivlerësimit ka pasqyruar me përfaqësi të ardhurat e kursimeve familjare që janë përfituar nga babai i tij, duke përfshirë të ardhurat nga paga për shkak të punës tek Forcat e Armatosura, të ardhura nga aktivitete të tjera brenda vendit dhe në institucione ndërkombëtare, si dhe të ardhura nga dietat në kuadër të aktiviteteve si ekspert ndërkombëtar, duke identifikuar disa prej tyre. Subjekti ka vënë në dispozicion një tabelë përmbledhëse, ku ka pasqyruar me përfaqësi vlerat minimale të të ardhurave të përfituara nga babai i tij A. M., në total në shumat 511.000 USD dhe 2.640.000 lekë, por nga ana e subjektit nuk disponohet asnjë dokumentacion provues mbi të ardhurat e pretenduara nga puna e babait të tij.

**101.** Nga hetimi i kryer nga Komisioni e vetmja e ardhur e identifikuar në kohën më të afërt me investimin në bono thesari në datën 5.1.2009, në shumën 4.000.000 lekë, janë të ardhurat e përfituara më 22.9.2005 nga shitja e apartamentit me sip. 53 m<sup>2</sup> në shumën 1.200.000 lekë, sipas kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.9.2005 ( ¾ pjesë takuese e vlerës së shitjes së pasurisë prej 1.600.000 lekësh).

**102.** Konstatohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka depozituar dokumentacion ligjor për të provuar burimin e ligjshëm të të ardhurave të nënës së tij, pasuri e cila është trashëguar 100% nga subjekti i rivlerësimit me dëshmi trashëgimie.

**103.** Nga administrimi i të dhënave bankare rezulton se nëna e subjektit ka deklaruar në Bankën e Shqipërisë në vitin 2008 si adresë banimi të saj apartamentin me qira në rrugën “\*\*\*\*” dhe se ka vijuar ta deklarojë po këtë adresë edhe në vitet 2014 - 2015 në BKT dhe “Raiffeisen Bank”. Në procesverbalin e mbajtur në datën 1.8.2014 pranë ILDKPKI-së<sup>36</sup>, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se jeton me nënën e tij në apartamentin që kjo shtetase ka marrë me qira në rrugën “\*\*\*\*”.

**104.** Gjatë hetimit administrativ Komisioni ka pyetur subjektin e rivlerësimit lidhur me deklaratimet e tij për jetesën me nënën dhe mbi mënyrën e përdorimit të kësaj pasurie për periudhën 2012 – 2019, i cili, në përgjigje të pyetësorit datë 19.4.2022, ka shpjeguar se nuk

---

<sup>36</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 3.4.2022.

është në dijeni të arsyes së deklaramit të adresës “\*\*\*\*” nga ana e nënës së tij, por ky veprim mund të jetë kryer me qëllim garantimin e dërgimeve të postës. Lidhur me përdorimin e pasurisë apartament banimi, subjekti ka shpjeguar se: *“Në lidhje me pyetjen tuaj nëse jam në dijeni për çfarë është përdorur apartamenti nga viti 2012 deri në vitin 2019 me vdekjen e trashëgimlënësës, dua të sqaroj se asnjëherë nuk jam interesuar në detaje në lidhje me mënyrën e përdorimit të pasurive të prindit tim, por me sa jam në dijeni pasuria është përdorur për banim nga e ndjera (duke qenë se herë pas here banonte edhe në shtëpinë private në bashkëpronësi të trashëguar prej prindërve të saj) dhe në periudha të caktuara mund dhe ta ketë dhënë me qira”*.

**105.** Në përfundim të hetimit për këto pasuri, Komisioni vlerëson se, kur ka dyshime, duhet të analizojë dhe evidentojë saktë marrëdhënien juridike që lidh subjektin e rivlerësimit me pasurinë në hetim, në drejtim të verifikimit të çdo fakti apo rrethane që mund të ngrejë dyshime për fshehjen e mundshme apo paraqitjen në mënyrë të pasaktë të pasurive nga ai, që mund të rezultojnë të jenë krijuar me kontribut nga vetë subjekti i rivlerësimit, por që janë në emër të personave të tjerë. Në rastin objekt shqyrtimi, pavarësisht se pasuritë janë përfituar me trashëgimi ligjore dhe pas dorëzimit të deklaratës *Vetting*, Komisioni, në kuadër të një vendimmarrjeje sa më të drejtë, pas administrimit të provave të mbledhura gjatë hetimit dhe në analizë të shkaqeve të rrethanave të rezultuara, i ka konsideruar këto pasuri të dyshuara si pasuri të fshehura të subjektit duke i kaluar atij barrën e provës.

**106.** Pas kalimit të barrës së provës për dy pasuritë e mësipërme, të cilat nuk ishin pjesë e deklaratës *Vetting* dhe që ishin përfituar nëpërmjet dëshmisë së trashëgimisë, subjekti prapësoi: *“Siç kam sqaruar edhe më parë, midis meje dhe nënës sime apo çdo pjesëtari tjetër të familjes sime të origjinës, nuk ekziston asnjë interes pasuror apo çdo marrëdhënie biznesi në kuptim të ligjit nr. 84/2016, si në formën e një transaksioni financiar, kontrate dhurimi, huadhënieje, huamarrjeje apo çdo veprimi tjetër juridik të çfarëdoshëm. Për më tepër, gjatë të gjithë periudhës së qenies sime në detyrën e gjyqtarit, nga data 17.4.2004 e në vijim unë kam sqaruar në përgjigje të pyetjeve standarde të datës 31.8.2020 se asnjëherë nuk kam bashkëjetuar me dikë. Në këtë kuptim, dua t’ju sqaroj se pavarësisht pranisë në certifikatën familjare të përbashkët me nënën në datën 7.7.2005 e deri në datën 18.4.2012, bashkim i cili u bë vetëm për qëllim lehtësie në marrje dokumentacioni pas ndërrimit jetë të tim eti në vitin 2005, unë kam jetuar më vete nga prindi.*

*I vetmi moment kur mund të ishte bërë cilësimi i të ndjerës si person i lidhur, ka qenë në gjallërinë e saj në vitin 2016 kur çastin e përpilimit të deklaratës *Vetting*, përpiluar dhe mbushur nga ana ime nëse nëna ime do të ishte konsideruar si person i lidhur nga ana e institucionit të ILDKPKI-së që administronte deklaratat e pasurisë për efekt të procesit të rivlerësimit, ajo do të duhet të kishte plotësuar deklaratën përkatëse të pasurisë dhe të pasqyronte pasuritë e saj.*

*Me vdekjen e saj në datën 17.4.2019, në kushtet kur ajo nuk është thirrur asnjëherë për të deklaruar në lidhje me pasurinë e saj dhe as si person i lidhur gjatë gjithë gjallërisë së saj, vlerësoj se nuk mund të më ngarkohet barra e provës për të provuar pasurinë e të ndjerës.*

*Në kuptim të përcaktimit të parashikuar nga neni 3, pika 14 dhe neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, vlerësimi i rrethanave të faktit në rastin konkret duhet të fokusohet në analizë në lidhje me barrën e provës. Sipas përkufizimit të dhënë në pikën 14 të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016,*

që një person fizik ose juridik të konsiderohet si 'person tjetër i lidhur me subjektin e rivlerësimit', duhet që të provohet një lidhje interesi mes tyre, e cila duhet të rrjedhë nga: (i) një interes pasuror; ose (ii) çdo marrëdhënie tjetër biznesi.

Përkufizimi i marrëdhënies së biznesit gjendet në radhën e përkufizimeve të nenit 3 të ligjit nr. 84/2016, në pikën 9 të tij, ndërsa lidhja e interesit që rrjedh nga një interes pasuror është trajtuar në nenin 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku përcaktohet në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie do të përfshihen në sferën e interesit pasuror.

Sipas kësaj dispozite: 'Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive'.

Pra, detyrimi për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive ekziston vetëm për ato subjekte ose persona të tjerë të lidhur midis të cilëve ka ekzistuar interesi pasuror, i cili duhet të jetë një marrëdhënie dhurimi, huamarrje ose huadhënie ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe një personi fizik ose juridik tjetër. Subjekti i kontrollit në procesin e rivlerësimit është subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur me të, prandaj specifika e procesit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe neneve 30-32 të ligjit nr. 84/2016 është që detyrimin për të shpjeguar bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë dhe të të ardhurave e ka vetë subjekti i rivlerësimit, përfshirë këtu edhe detyrimin për të provuar burimin e ligjshëm të pasurisë së krijuar nga dhurime apo huamarrje të konfirmuara nga persona të tjerë të lidhur, si dhe të pasurisë së dhënë hua apo të dhuruar nga subjekti i rivlerësimit. Në interpretim të këtyre dispozitave kushtetuese dhe ligjore, provueshmëria e ligjshmërisë së burimeve të pasurisë së dhuruar apo të dhënë hua nga subjekti i rivlerësimit apo personat e tjerë të lidhur, është një proces në të cilin subjekti i rivlerësimit duhet të provojë ligjshmërinë e burimit, ndërkohë që edhe vetë personat e tjerë të lidhur kanë detyrimin të provojnë ligjshmërinë e burimeve për krijimin e pasurisë së dhuruar ose huazuar, nëse konfirmojnë marrëdhënien sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Duke u kthyer në zbatimin e këtyre dispozitave në rastin konkret, unë si subjekt i rivlerësimit ndodhem në situatën e qartë të një regjimi pasuror të ndarë me anëtarët e tjerë të familjes dhe në situatën ku nuk kam kontribuar asnjëherë në krijimin e pasurisë apartament me sip. 124.27 m<sup>2</sup> në pronësi të nënës sime të ndjerë, pasi midis meje dhe të ndjerës asnjëherë nuk janë kryer transaksione të asnjë lloji, dhe asnjëherë nuk kam kontribuar për pasurinë e saj dhe as përdorur e përfituar nga kjo pasuri në asnjë rrethanë. Gjithashtu, nëse do të verifikohen deklaratat e mia të pasurisë si subjekt i rivlerësimit, të dorëzuara në ILDKPKI, unë kam deklaruar vetëm të ardhurat nga paga dhe nuk kam deklaruar asnjëherë dhënie huaje apo dhurime të personave të tjerë. Në këto kushte, duke qenë se nëna ime e ndjerë ka ndërruar jetë në datën 17.4.2019, e kam të pamundur të gjej dokumentacion duke qenë se ajo nuk është më gjallë dhe nuk mund të më japë referime lidhur me mënyrën e krijimit të pasurisë së saj.

Në deklarinimin periodik vjetor 2019 kam bërë rregullisht deklarinimin e pasurive të përfituara nga trashëgimia në përputhje me udhëzuesin e vitit 2017 të ILDKPKI-së "Mbi plotësimin e dokumentit zyrtar deklaratë e interesave privatë" faqet 26-44, duke u deklaruar pasuritë përkatëse të përfituara me burim nga trashëgimia dhe burimi i krijimit të tyre është trashëgimia ligjore nga trashëgimlënësja ime, prindi T. I. Me sa jam në dijeni, siç ju kam sqaruar dhe më parë, pasuria në fjalë e llojit apartament me sip. 124.27 m<sup>2</sup>, si dhe depozita bankare e derdhur

*nga e ndjera nëna ime, rezulton se ka si burim krijimi kursimet e gjithë jetës së babait dhe nënës sime (i cili, pas vdekjes, të gjitha kursimet e krijuara gjatë gjithë jetesës së tyre të përbashkët ia la nënës sime)”*.

**107.** Më tej, subjekti është përpjekur të paraqesë mundësitë e prindërve të tij për të siguruar të ardhurat që kanë shërbyer si burim për këto pasuri, duke parashtruar se babai i tij, i ndjeri A. S. M., i datëlindjes 19.12.1946, ka qenë një nga figurat kryesore të inxhinierisë së kimisë organike në Republikën e Shqipërisë dhe një nga ekspertët kimistë me të kualifikuar të vendit dhe, si i tillë, ishte i vlerësuar jo vetëm brenda vendit, por edhe jashtë vendit nga një sërë organizatash botërore si OPCW (Organizata Botërore e Ndalimit të Armëve Kimike) dhe NATO (Traktati i Atlantikut të Veriut), si dhe një nga bashkëpunëtorët kryesorë të SHBA-së në Forcat e Armatosura Shqiptare, ku rezulton se ishte tej mase i vlerësuar nga partnerët tanë ndërkombëtarë dhe gjithnjë i pranishëm në çdo aktivitet festiv të Ambasadës së SHBA-së, Ambasadës Austriake, Gjermane e asaj Zvicerane në Republikën e Shqipërisë. I ndjeri ka qenë autor i një sërë studimesh dhe botimesh shkencore, si dhe ishte pjesëtar aktiv dhe oficer madhor i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë me grada të ndryshme, deri në gradën madhore “Kolonel” me vdekjen e tij në vitin 2005. Rezulton se ai është dekoruar dhe vlerësuar jo vetëm nga Republika e Shqipërisë, por edhe nga partneret tanë ndërkombëtarë (NATO). Prej vitit 1996 e në vijim ai, përveç detyrave në ushtrinë shqiptare, ishte edhe në ushtrim të funksioneve të Autoritetit Kombëtar për Zbatimin e Konventës për Ndalimin e Armëve Kimike dhe në këtë kuadër u përfshi si një nga ekspertët kimistë më të vlerësuar në fushën e mbrojtjes dhe ndalimit të armëve kimike pranë OPCW (Organizata Botërore e Ndalimit të Armëve Kimike) dhe prej vitit 1996 e në vijim edhe një nga ekspertët kyç të NATO-s (Traktati i Atlantikut të Veriut) në Republikën e Shqipërisë.

Përveçse pjesëtar i Forcave të Armatosura e me një pagesë që në periudhën kohore kur ka qenë gjallë ka qenë nga më e larta në Republikën e Shqipërisë duke variuar nga 50.000 deri në 100.000 lekë/muaj (në vite të ndryshme), detyra shtetërore në Republikën e Shqipërisë në pjesëmarrjen në borde përkatëse, subjekti pretendon se babai i tij ka pasur një aktivitet tej mase të zgjeruar në fushën e ekspertizës ushtarake, asaj të mjedisit e fushës së ndalimit të armëve kimike, duke qenë ekspert i angazhuar pranë Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike (OPCW) prej vitit 1996 e në vijim, ekspert i angazhuar në NATO nga viti 1996 e në vijim, e gjithashtu pjesëmarrës në një numër shumë të madh seminaresh, konferencash e aktiviteteve trajnuese të organizuara brenda e jashtë vendit. Më konkretisht ai liston këto të ardhura:

### **1. Të ardhurat nga paga për shkak të punës në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë**

- komandant Kompanie Autonome Kimie në vitet 1967 – 1969;
- pedagog në Katedrën e Kimisë në Akademinë e Forcave Tokësore Skënderbej në vitet 1973 – 1977;
- shef i Sektorit të Mjeteve të Mbrojtjes Kundërkimike në Laboratorin Qendror Kimik të Ushtrisë në vitet 1977 – 1984;
- shef i katedrës së Kimisë në Akademinë e Forcave Tokësore Skënderbej në vitet 1984 – 1988;

- pedagog në Katedrën e Kimisë në Akademinë e Forcave Tokësore Skënderbej në vitet 1988 – 1993;
- shef i Laboratorit Qendror të Ushtrisë në vitet 1993 – 1997;
- specialist për Mbrojtjen e Mjedisit në Ushtri, Drejtor i Përgjithshëm i Kimisë pranë Ministrisë së Mbrojtjes dhe Autoritet Kombëtar për Zbatimin e CWC prill 1996 – shtator 1999;
- ndihmës i zëvendës-shefit të Shtabit të Përgjithshëm të Ushtrisë për Kiminë, Autoritet Kombëtar për Zbatimin e CWC shtator 1999 – shtator 2000;
- ekspert për Armë Kontrollin Kimik, Autoritet Kombëtar Për Zbatimin e CWC shtator 2000 – 2003;
- ekspert për Mjedisin, pranë Drejtorisë së Logjistikës në Shtabin e Përgjithshëm të Forcave të Armatosura janar 2003, Autoritet Kombëtar për Zbatimin e CWC – janar 2003, e në vijim.

## **2. Të ardhura nga aktivitete të tjera brenda vendit dhe në institucione ndërkombëtare**

- kryetar i Komitetit Teknik për Standardizimin e Mjeteve të Mbrojtjes Personale në vitet 2000 – 2005 në Republikën e Shqipërisë – në dizenj të subjektit pagesa në këtë pozicion ka qenë në trajtën e honorarëve për çdo mbledhje pune të këtij bordi rreth 10.000 lekë/muaj për çdo mbledhje ku çdo muaj ka pasur të paktën 2-3 mbledhje pune;
- anëtar i Komitetit Shqiptar të Standardizimit të Republikës së Shqipërisë në vitet 1993 – 1999 – në dizenj të subjektit pagesa në këtë pozicion ka qenë në trajtën e honorarëve për çdo mbledhje pune të këtij bordi rreth 10.000 lekë/muaj për çdo mbledhje ku çdo muaj ka pasur të paktën 2-3 mbledhje pune;
- anëtar i Grupit të Punës për Mbrojtjen e Mjedisit, ekspert pranë Environmental Training Working Group (ETWG) të NATO-s në vitet 1996 – 2005 – në dizenj të subjektit pagesa në këtë pozicion ka qenë në trajtën e honorarëve rreth 2.000 USD/muaj;
- ekspert pranë Organizatës për Ndalimin e Armëve Kimike, OPCW, në vitet 1996 – 2005 – në dizenj të subjektit pagesa në këtë pozicion ka qenë në trajtën e honorarëve rreth 1.500 - 2.000 USD/muaj;
- anëtar i Grupit të Punës për Nivelet e Ulëta të Rrezatimit gjatë Operacioneve Ushtarake, ekspert pranë Working Group for Low Level of Radiation on Military Operations të NATO-s në vitet 1998 – 2000 (dekoruar nga Traktati i Atlantikut të Veriut për punën e bërë në Grupin e Punës për Nivelet e Ulëta të Rrezatimit gjatë Operacioneve Ushtarake në gusht 2000) – në dizenj të subjektit pagesa në këtë pozicion ka qenë në trajtën e honorarëve rreth 2.000 – 3.000 USD/muaj;
- koordinator i Projektit të Shkatërrimit të 20 Tone Lëndëve Helmuere Luftarake në Republikën e Shqipërisë, 1998 - verë 2001 “\*\*\*”, projekt i realizuar në bashkëpunim midis Republikës së Shqipërisë, shtetit zviceran dhe SHBA-së në kuadër të bashkëpunimit midis OPCW – NATO - Spiez Laboratory SWISS – në dizenj të subjektit si koordinator i projektit ka përfituar në përfundim të tij një honorar në shumën rreth 30.000 USD nga financuesit e këtij projekti.

## **3. Të ardhura nga dietat në kuadër të aktivitetit si ekspert pranë organizatave ndërkombëtare dhe udhëtimeve jashtë shtetit në këtë kuadër apo në kuadër të trajnimeve përkatëse**

Në këtë kuadër, në dijëni të subjektit, në ushtrim të aktivitetit pranë organizatave ndërkombëtare ku ai ka marrë pjesë si ekspert, lektor, bashkëpunëtor shkencor apo ushtarak ose i trajnuar, i ndjeri ka përfituar edhe dietat përkatëse nga këto aktivitete.

**108. Subjekti ka paraqitur disa prej aktiviteteve të identifikuara, ku ka marrë pjesë babai i tij:**

- kurs për oficerët e NBC në Shkollën e NATO-s, Oberamergau, Gjermani, Garmisch, 1998;
- kurs për Mbështetjen gjatë Aksidenteve Kimike, 1 muaj, Revinge, Suedi, nëntor 1999;
- kurs bazë për verifikimin e CWC, VERIFIN, Helsinki, Finlandë, 4 muaj, shkurt - maj 2000 – në dijëni të subjektit rezulton një pagesë shtesë për këtë trajnim në masën 2.500 USD/muaj që paguhej nga OPCW-ja;
- kurs i avancuar për verifikimin e CWC, VERIFIN, Helsinki, Finlandë, 4 muaj, gusht - dhjetor 2001 – në dijëni të subjektit rezulton një pagesë shtesë për këtë trajnim në masën 2.500 USD/muaj që paguhej nga OPCW-ja;
- kurs për trajnimin e shefave instruktorë për mbrojtjen civile, Spiez, Zvicër, prill - maj 2001;
- kurs për Mbrojtjen Civile nga Përdorimi i Agjentëve Kimike të Fushës së Luftës, Lazne Bohadec, Republika Çeke, një javë gusht 1999;
- kurs bazë për Personelin e Autoriteteve Kombëtare për Problemet e Konventës së Ndalimit të Armëve Kimike, 10 ditë, Snagov, Rumani, tetor 1999.

**109.** Subjekti ka pretenduar se nga analiza e dy pasaportave të gjetura nga ana e tij dhe të përdorura prej të ndjerit në periudhën 1996 – 2005, rezultojnë një numër prej afërsisht 700 - 800 ditësh shërbimi jashtë shtetit dhe, për pasojë, me sa është në dijëni, edhe të përfitimit të dietave për shkak të zhvillimit të tyre në shtete të ndryshme si Gjermani, Suedi, Finlandë, Francë, Çeki, Sllovakia, Zvicër, Turqi, SHBA, dieta që rezultojnë të jenë përfituar si nga OPCW ashtu edhe NATO apo organizues të tjerë të këtyre aktiviteteve.

**110.** Subjekti ka vijuar: *“Me sa jam në dijëni, përveç mbulimit të shpenzimeve për marrjen e shërbimit të vizës dhe pagesës së biletës së udhëtimit me avion, nga ana e këtyre organizatave ndërkombëtare mbulohej një shpenzim ditor në vlerën 150-250 USD/dita për fjetjen në hotel dhe, po kështu, ishte i përfshirë edhe një shpenzim ditor për nevoja diete në vlerën 100 - 200 USD/dita, shuma këto që jepeshin cash dhe prej tyre ai kishte mundësinë që të kursente pjesën më të madhe të tyre, duke qenë se kishte lirinë e zgjedhjes së hotelit dhe po kështu mund të menaxhonte shpenzimet për menunë përkatëse ushqimore. Deri në momentin e ndërrimit të jetës së babait tim në mënyrë të papritur në maj të vitit 2005, të gjitha këto shuma kursimi që më rezultojnë të ishin të larta, me sa jam në dijëni janë mbajtur nga prindërit jashtë sistemit bankar, duke qenë se më rezulton se të dy ishin të ndikuar nga mosbesimi në sistemin bankar për shkak të ngjarjeve të vitit 1996 – 1997, kur ndodhi edhe falimentimi i skemave piramidale dhe, po kështu, rrënimit në atë periudhë të sistemit bankar shqiptar. Me vdekjen e tim eti, pavarësisht se unë isha një nga trashëgimtarët e tij, të gjitha shumat e kursimeve familjare i mbetën tërësisht të ndjerës nënës sime, për shkak se moralisht unë asnjëherë nuk kisha kontribuar në krijimin e tyre dhe, për pasojë, nuk mund të kisha asnjë pretendim mbi këto kursime. Në këtë kuadër mund të them se me sa jam në dijëni shumat përkatëse të kursimeve të sipërcituara më rezulton se në çastin e vdekjes së tim eti të kenë qenë afërsisht në shumën 350.000 USD, e po kështu me sa jam në dijëni këto kursime familjare janë edhe burimi i krijimit të pasurive në trajtën e pasurisë apartament dhe depozitë për bono thesari që janë krijuar më pas nga e ndjera nëna ime”.*

**111.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, provat e depozituara prej tij në seancë dëgjimore, por edhe gjatë procesit të rivlerësimit, provat e administruara gjatë hetimit, si dhe e dëgjoji subjektin në seancë dëgjimore, vlerëson se në lidhje me këto pasuri duhet bërë një analizë në dy këndvështrime.

**112.** Së pari, në këndvështrimin formal procedural, pasuria apartament, si dhe bonot e thesarit, kanë qenë në pronësi të znj. T. I., nënës së subjektit. Ato kanë kaluar në favor të subjektit bazuar në dëshminë e trashëgimisë, pra si burim në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, ka shërbyer dëshmia e trashëgimisë së nënës së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti është përcaktuar si trashëgimtari i vetëm ligjor i të gjitha pasurive të trashëgimlënësës T. I., sipas dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2019. Në vijim të kësaj dëshmie është bërë edhe regjistrimi në datën 1.7.2019 i pasurisë në emër të subjekti të rivlerësimit.

**113.** Të dyja pasuritë e mësipërme nuk kanë qenë pjesë e deklaratës *Vetting* dhe, për rrjedhojë, bazuar edhe në jurisprudencën e konsoliduar<sup>37</sup> të Kolegjit të Posaçëm të Apelit ato nuk mund të jenë objekt i ligjit nr. 84/2016, për sa kohë edhe burimi i tyre nuk lidhet me pasuri ose të ardhura të deklaruara nga subjekti në deklaratën *Vetting*.

**114.** Gjatë hetimit nuk u provua që dy pasuritë e mësipërme të jenë shfrytëzuar apo përdorur nga subjekti i rivlerësimit si përpara plotësimit të deklaratës *Vetting*, por dhe pas saj, deri në momentin e çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, por dhe as të ketë pasur ndonjë kontribut financiar prej tij në krijimin e tyre. Në lidhje me llogarinë bankare rezultoi e provuar se të ardhurat nga interesat janë tërhequr nga nëna e subjektit dhe, rrjedhimisht, janë përdorur prej saj.

**115.** Për sa i përket pasurisë apartament, nga ana e OSHEE-së është konfirmuar që ajo nuk është shfrytëzuar, për rrjedhojë nuk provohet që kjo pasuri të ketë qenë qoftë edhe në përdorim të fshehur apo hipotetik të subjektit, në mënyrë të tillë që të ngriheshin dyshime për pasuri të fshehur.

**116.** Subjekti, gjatë gjithë procesit të rivlerësimit, ka pretenduar se nëna e tij nuk mund të konsiderohet person i lidhur me të apo tjetër i lidhur me të. Në lidhje me këtë pretendim të subjektit, Komisioni vlerëson se ai është i drejtë, pasi në deklaratën *Vetting*, por edhe gjatë hetimit, nëna e subjektit nuk rezultoi në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit apo huamarrësit në kuptim të nenit 32/4 të ligjit nr. 84/2016, për rrjedhojë ajo nuk kishte detyrimin ligjor për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive të saj. Në këtë kontekst, subjekti nuk kishte detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të pasurive apartament dhe llogari bankare, për sa kohë përfitimi/burimi i këtyre pasurive nga subjekti rezultoi i provuar që është nga dëshmia e trashëgimisë.

**117.** Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë edhe faktin se në rastin kur nëna e subjektit nuk do të kishte ndërruar jetë, përpara përfundimit të procesit të rivlerësimit për këtë subjekt këto pasuri nuk do të hetoheshin nga Komisioni, për sa kohë nuk plotësoheshin kriteret e parashikuara nga neni 32/4, kjo bazuar edhe në standardet e hetimit të Komisionit për subjektet

---

<sup>37</sup> Vendim nr. 8, datë 9.3.2021.



e tjera të rivlerësimit, por edhe në jurisprudencën e konsoliduar të Kolegjit<sup>38</sup>. Për më tepër, në rast se subjekti do të kishte pasur për qëllim fshehjen e këtyre pasurive në emër të nënës së tij, apartament i blerë në vitin 2012, i papërdorur deri në qershor të vitit 2019, si dhe bonot e thesarit të investuara që në vitin 2009, duke qenë ligjërisht trashëgimtari i vetëm ligjor i nënës së tij, nuk kishte asnjë arsye për të çelur menjëherë<sup>39</sup> dëshminë e trashëgimisë apo për të regjistruar këto pasuri në emër të tij. Në rast se qëllimi i tij do të kishte qenë fshehja e pasurive, ai mund të kishte pritur përfundimin e procesit të rivlerësimit të tij dhe pastaj të formalizonte e të përfitonte nga çelja e dëshmisë. Në një rast të tillë, këto pasuri nuk do t'i ishin nënshtruar këtij verifikimi. Pikërisht lidhur me këtë dinamikë, i pyetur në seancë dëgjimore, subjekti është shprehur se ai ka vepruar pa humbur kohë për aktivizimin e procedurave për çeljen e trashëgimisë në fjalë – ndonëse ishte në proces e sipër të rivlerësimit – pikërisht pasi nuk kishte asgjë për të fshehur, pasi burimet financiare të përdorura ishin kursimet e prindërve.

**118.** Gjithsesi, përtej këtij arsyetimi, Komisioni çmon të vlerësojë edhe nga pikëpamja substanciale burimin e ligjshëm të të ardhurave të këtyre pasurive.

**119.** Në lidhje me burimin e këtyre pasurive, subjekti, pavarësisht faktit se gjatë gjithë procesit ka deklaruar se nëna e tij nuk është person i lidhur me të ose tjetër i lidhur, në kuadër të bashkëpunimit, për sa kohë i është kërkuar nga Komisioni, ka dhënë shpjegime dhe ka paraqitur dokumentacion, i cili ndonëse pjesërisht mbetet në nivel deklarativ për sa i përket të ardhurave të babait të subjektit<sup>40</sup>, nga ana tjetër, në tërësinë e provave të dorëzuara nga subjekti dhe duke pasur në vëmendje dinamikën e ngjarjeve dhe kushtet e kontekstin në të cilin është gjendur ky i fundit përgjatë hetimit administrativ, në raport me provueshmërinë e çfarë i është kërkuar atij që të provojë, krijohet bindja se babai i tij ka krijuar të ardhura të konsiderueshme, të cilat mund të kenë shërbyer për krijimin e pasurive të mësipërme. Ky qëndrim mbështetet edhe në shkresën nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2022, të Ministrisë së Mbrojtjes, sipas së cilës konfirmohet fakti se z. A. M.:

- Ka qenë ushtarak aktiv me gradën “Kolonel” dhe në vitin 2002 ka dalë në rezervë nga shërbimi aktiv.

<sup>38</sup> Vendimet e Kolegjit: nr. 8/2020 (JR), datë 25.6.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. A. K.; nr. 21/2020 (JR), datë 10.9.2020, që i përket subjektit të rivlerësimit R. J.; nr. 4/2021 (JR), datë 9.2.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit E. B.; nr. 24/2021 (JR), datë 28.7.2021, që i përket subjektit të rivlerësimit L. H.; nr. 10/2022 (JR), datë 14.4.2022, që i përket subjektit të rivlerësimit F. I. etj.

<sup>39</sup> Nëna e subjektit ka ndërruar jetë më 18.4.2019 dhe subjekti e ka çelur dëshminë e trashëgimisë më 31.5.2019.

<sup>40</sup> Në lidhje me këto të ardhura subjekti ka depozituar: (i) fotokopje të pasaportave të babait të tij ku evidentohet një numër i konsiderueshëm vizash, si dhe hyrje-dalje të shumta të babait të subjektit; (ii) certifikatë pjesëmarrjeje e babait në konferencën ndërkombëtare mbi mjedisin ushtarak zhvilluar në Pekin më 12 - 14 tetor 2004; (iii) shkresë e Shtabit të Përgjithshëm me logo të flamurit zviceran, e cila i dërgohet babait të subjektit në cilësinë e Drejtuesit të Autoritetit Kombëtar të Shqipërisë në lidhje me marrëdhëniet me \*\*\*, sipas së cilës babai i subjektit ka marrë pjesën në kursin \*\*\* më 22 - 27 prill 2001; (iv) vërtetim nga Agjencia e Prokurimit të Mbrojtjes me logo të flamurit zviceran që mban datën 28.1.2002, sipas të cilit vërtetohet se babai i subjektit ka kontribuar në projektin \*\*\*, në cilësinë e koordinatorit të projektit për periudhën 1998 – 2001; (v) certifikatë për kursin e trajnimit mbi Verifikimin e Agjentëve Kimikë të luftës më 20 gusht - 14 dhjetor 2001; (vi) certifikatë pjesëmarrjeje në trajnimin mbi Mbrojtjen Civile data 9 - 14 gusht 1999; (vii) certifikatë për përfundimin e trajnimit \*\*\* NATO për periudhën 19-23 janar 1998, lëshuar nga NATO SCHOOL; (viii) letër mikpritëse në Shkollën e Mbrojtjes \*\*\* dhe Vetëmbrojtjes; (ix) një foto nga Konferenca e Paqes, organizuar nga USEUCOM në vitin 1999. (x) urdhri “Naim Frashëri, Klasi III”; (xi) certifikatë pjesëmarrjeje, lëshuar nga NATO \*\*\* për kursin mbi mbrojtjen e mjedisit nga forcat ushtarake më 17-28 nëntor 2003; (xii) certifikatë pjesëmarrjeje në Simpoziumin e Trajtimit Mjekësor Kimik dhe Biologjik më 28 prill - 3 maj 2002; (xiii) certifikatë pjesëmarrjeje në NATO Working Group 2, më 24.8.2000; (xiv) certifikatë pjesëmarrjeje, lëshuar nga Departamenti i Mbrojtjes i SHBA-së për kursin mbi armët e shkatërrimit në masë më 19 - 23 janar 2004; (xv) foto të babait të tij në evente të ndryshme ndërkombëtare.

- Në lidhje me angazhimet e tij në organizatat ndërkombëtare ai nuk është trajtuar financiarisht nga Ministria e Mbrojtjes, por nga strukturat e NATO-s dhe nga organizatat me të cilat është angazhuar.
- Për periudhat si kursant jashtë vendit ai është trajtuar financiarisht me pagën bazë si ushtarak aktiv, ndërsa për trajtimin financiar nga shteti pritisë nuk disponohet informacion.

Nga dokumentacioni bashkëlidhur kësaj shkrese rezulton se babai i subjektit është trajtuar me pagesë kalimtare për periudhën 1.1.2003 – 1.1.2005<sup>41</sup>, si dhe nga data 16.1.2003 ka qenë i punësuar pranë Drejtorisë së Logjistikës si specialist me kontratë në SHPFA<sup>42</sup>.

**120.** Nga analiza e dokumentacionit të administruar konstatohet se babai i subjektit ka qenë aktiv në marrëdhëniet e punësimit të tij, ka qenë i angazhuar në aktivitete kombëtare e ndërkombëtare, pagesa e të cilave mbetet e paqartë, për shkak të kohës së gjatë, si dhe për shkak të llojit të angazhimit, pavarësisht tentativave të kryera si nga Komisioni, ashtu edhe nga vetë subjekti për të qartësuar në aspektin sasior këto të ardhura. Në këtë kontekst, edhe kjo veçanti e marrëdhënieve të punësimit dhe të shërbimeve të kryera nga babai i subjektit, që përgjatë procesit të rivlerësimit ka përbërë një vështirësi objektive e konkrete për të provuar fitimet dhe kursimet e gjeneruara ndër vite – sikurse specifikohet në vijim – do të mbahet në konsideratë në vlerësimin përfundimtar, nën dritën e parimit të proporcionalitetit.

**121.** Nga dokumentacioni i administruar duket se subjekti ka bërë çdo përpjekje për të siguruar të dhëna të sakta për të ardhurat e babait. Të njëjtën gjë mund të themi edhe për hetimin e Komisionit. Në të dyja rastet, përpos kryerjes së hetimeve të gjata e të përsëritura, rezultati ka qenë i paqartë dhe i paplotë, duke mos mundësuar bërjen e një analize financiare për prindërit e subjektit në kohën kur kanë qenë gjallë. Këtij fakti i duhet shtuar edhe koha e gjatë që ka kaluar, vështirësitë në identifikimin e marrëdhënieve të punës së babait të subjektit me organizatat ndërkombëtare, vdekja e prindërve të subjektit, veçanërisht babait të tij që në vitin 2005. Të gjitha këto arsye janë pengesë evidente në identifikimin e të ardhurave, duke e vendosur subjektin në kushtet e nenit 32/2 të ligjit nr. 94/2016.

**122.** Pavarësisht sa është shprehur më sipër, *indiciet* mbi të ardhurat e babait të subjektit janë të shumta. Fletët e pasaportës së tij, hyrje-daljet në vend, tregojnë për angazhimet e tij, Ministria e Mbrojtjes evidenton qartë faktin se pagesat e tij janë kryer nga organizmat ndërkombëtare, niveli i organizatave ndërkombëtare apo aktiviteteve që ai ka marrë pjesë tregojnë dukshëm për rëndësinë e punës së tij, që është *indicia* për një nivel të kënaqshëm të ardhurash. Komisioni vlerëson se shuma 350.000 euro, e pretenduar nga subjekti, nuk është bindëse, por kjo nuk do të thotë se kanë munguar burimet financiare në shumën e përdorur nga nëna e subjektit, që ka shërbyer si burim për krijimin e pasurisë në analizë – konkretisht për plotësimin dhe shtimin e shumave të disponuara nga shitja e pasurive të paluajtshme në vitin 2005, që ka gjeneruar fitim *neto* në vlerën 1.200.000 lekë (ose 1.600.000 lekë) – sikurse është përshkruar edhe më sipër (pika 98). Kësisoj, duke mos e pasur këtë mundësi për vlerësimin gjithëpërfshirës dhe kristalizimin e saktësimin e pamundësisë financiare të mundshme për kursimin e shumave të përdorura nga nëna e subjektit, Komisioni vlerëson se nuk mund të mjaftojë kjo rrethanë paqartësie për penalizimin e subjektit, për sa kohë ky i fundit i ka kryer të gjitha përpjekjet e mundshme për qartësimin e situatave dhe dinamikave të lartpërshkuara.

<sup>41</sup> Shihni vërtetimin për efekt pensioni nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2015.

<sup>42</sup> Shihni kartelën personale të oficerit.

**123.** Nga ana tjetër, pasuria apartament përpara nënshkrimin të kontratës midis nënës së subjektit dhe blerësve është rivlerësuar në datën 9.4.2012 për vlerën 16.776.450 lekë dhe është paguar detyrimi tatimor me mandatarkëtimin datë 9.4.2012 të “Credins Bank” në vlerën 148.765 lekë. Vetëm pas rivlerësimit të saj është lidhur kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 14.4.2012, nga nëna e subjektit për blerjen e kësaj pasurie sipas çmimit të rivlerësimit prej 16.776.450 lekësh, e cila për më tepër është likuiduar *cash* në zyrën noteriale.

Nëse subjekti do të kishte pasur për qëllim fshehjen e pasurisë nuk kishte pse të përdorte si referencë çmimin e rivlerësuar, pasi mund të mos bëhej apo deklarohej rivlerësimi dhe/ose çmimi i (deklaruar) shitblerjes mund të kishte qenë shumë më i ulët, si dhe nuk kishte asnjë arsye që pagesa *cash* të bëhej në zyrën e noterit, por mund të ishte likuiduar jashtë saj.

**124.** Për sa më sipër, rezulton e provuar se pagesa për këtë pasuri është kryer nga nëna e subjektit duke u provuar që ajo i ka disponuar *de facto* këto të ardhura. Për sa i përket burimit të këtyre të ardhurave, ndonëse nuk është në objekt të Komisionit hetimi i tyre, për sa kohë pasuria, jo vetëm që nuk ka qenë pjesë e deklaratës *Vetting*, por as nuk është përdorur, si dhe ka kaluar në emër të subjektit vetëm pas çeljes së dëshmisë së trashëgimisë, as nuk mund të konkludohet se prindërit e subjektit nuk mund të kishin kursyer shumat e investuara.

**125.** Në këto kushte e duke mbajtur në vëmendje sa më sipër, trupi gjykues i vlerëson shpjegimet e subjektit si bindëse në logjikën e tyre lidhur me burimin e të ardhurave të përdorura për krijimin e kësaj pasurie, ndonëse jo të provuara plotësisht (as që nuk mund të përjashtohet mundësia), duke i pranuar ato në pamundësi objektive për të kryer një analizë financiare të mirëfilltë. Ky konkluzion arrihet pasi nga tërësia e veprimeve të kryera dhe dokumentacionit e informacioneve të administruara të njohura përgjatë hetimit administrativ, u krijua bindja se banesa ishte e nënës së subjektit dhe se në këto kushte nuk mund të konkludohej për një pasuri të fshehur. Vetëm pas vitit 2019 kjo banesë ka filluar të përdoret rregullisht, e dhënë kjo që rezulton edhe nga boksi i përdorimit të energjisë elektrike, me një rritje të konsumit mujor të energjisë elektrike.

**126.** Komisioni, duke marrë në konsideratë shpjegimet e subjektit pas kalimit të barrës së provës, provat indirekte në lidhje me të ardhurat e mundshme të prindërve të tij, si dhe faktin që burimi primar i kësaj pasurie është trashëgimia, vlerëson se, përpos dyshimeve të ngritura, nuk kanë rezultuar mjaftueshëm elemente bindëse për të konkluduar se gjendet përpara një pasurie të fshehur.

**127.** Në përfundim, trupi gjykues vlerëson se pasuria apartament dhe llogaria bankare janë pasuri të krijuara nga nëna e subjektit të rivlerësimit në një mënyrë të ligjshme, të cilat ai i ka përfituar përmes trashëgimisë dhe nuk mund të penalizohet për paqartësitë e mbetura lidhur me detajet e formimit të kursimeve të prindërve të tij.

**128.** Gjithashtu, vlen të përmendet se në analizë të marrëdhënies së subjektit me të dyja këto pasuri nuk i është dhënë një kualifikim këtyre marrëdhënieve, sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, që do të çonte subjektin e rivlerësimit në detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, sipas këtij parashikimi ligjor. Për më tepër, bazuar në kuadrin ligjor që normon procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve, trupi gjykues sjell në vëmendje se subjektet e rivlerësimit mbajnë përgjegjësi për saktësinë, vërtetësinë dhe mjaftueshmërinë e deklarimeve dhe gjendjes së pasurisë, deri në dorëzimin e deklaratës *Vetting*.

**129.** Në këto kushte, Komisioni arriti në përfundimin se, për shkak të fakteve dhe rrethanave specifike si më sipërtrajtuar, shpjegimet e subjektit të rivlerësimit konsiderohen të besueshme dhe bindëse, për sa kohë, në mungesë të provës së kundërt e gjithë dinamika e veprimeve të kryera nga nëna e tij në lidhje me këto pasuri e shkëput subjektin e rivlerësimit nga marrëdhënia direkte e pronësisë me këto sende për të gjithë kohën e krijimit të këtyre pasurive e deri sa nëna e tij ka qenë gjallë. Për rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se, përpos dyshimeve të ngritura përgjatë hetimit administrativ, nuk u verifikuan apo provuan fakte dhe/ose rrethana që mund të çonin përtej çdo dyshimi të arsyeshëm në një konkluzion të bazuar për fshehjen e këtyre pasurive nga ana e subjektit, që mund ta vendosnin këtë të fundit në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës.

Në përfundim, Komisioni çmon se duke mos u kristalizuar një pamjaftueshmëri e qartë mjetesh financiare për nënën e subjektit lidhur me krijimin e pasurive në analizë dhe në mungesë të provës së dhënies të ndonjë kontributi financiar nga ky i fundit, parë nën dritën e parimit të proporcionalitetit, si dhe duke mbajtur në konsideratë vështirësitë dhe pamundësitë e konstatuara përgjatë hetimit administrativ për të hedhur dritë mbi saktësimin sasior të kursimeve të mundshme të realizueshme nga prindërit e subjektit, në dekadat pararendëse nuk mund të mjaftojë vetëm fakti i përfitimit final të këtyre sendeve, për më tepër nëpërmjet aktit të trashëgimisë ligjore për të penalizuar subjektin e rivlerësimit.

**130.** Me çeljen e dëshmisë së trashëgimisë nënës së tij, subjekti ka përfituar edhe pasurinë shtëpi banimi me oborr, me sip. 255 m<sup>2</sup>, me vendndodhje në rrugën “\*\*\*\*”, Tiranë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni**

**131.** Drejtoria Vendore e ASHK-së Tiranë Veri<sup>43</sup> ka përcjellë për Komisionin dokumentacionin e disponuar për këtë pasuri. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të ASHK-së rezulton se kjo pasuri është blerë nga shtetasi Q. M. (babai i shtetasës T. I.) me anë të kontratës nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.2.1960, me palë shitëse ish-Komitetin Ekzekutiv të K. P. të qytetit Tiranë dhe çmim 153.000 lekë.

Nëpërmjet vendimit nr. \*\*\*, datë 20.7.1992, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë për trashëgimtarët e trashëgimlënësit Q. I. (gjyshi i subjektit të rivlerësimit), ku një ndër ta është edhe vajza e tij, shtetasja T. I., me të drejtë përfitimi 1/3 pjesë takuese.

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. \*\*\*, datë 12.5.1997, ka lëshuar dëshminë e trashëgimisë për trashëgimlënësen H. I. (gjyshja e subjektit të rivlerësimit), duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë shtetasit T. I. dhe A. I., me pjesë takuese ½. Pasuria shtëpi banimi është regjistruar në emër të shtetasve T. I. dhe A. I. (daja i subjektit të rivlerësimit), me pjesë takuese secili prej ½, sipas vërtetimit të pronësisë së hipotekës datë 13.12.1997.

**132.** Shtetasja T. I. ka ndërruar jetë në datën 18.4.2019 dhe me anë të dëshmisë së trashëgimisë ligjore nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.5.2019, është përcaktuar subjekti i rivlerësimit si trashëgimtari i vetëm ligjor i të gjitha pasurive të trashëgimlënëses T. I.

---

<sup>43</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2022.

Sipas kartelës së pasurisë rezulton se kjo pronë është regjistruar në datën 15.6.2021, në bashkëpronësi të subjektit të rivlerësimit dhe dajës së tij, shtetasit A. I., me pjesë takuese secili prej ½.

**133.** Nga hetimi i lëvizjes së llogarisë bankare të shtetasës T. I. në BKT<sup>44</sup> ka rezultuar se është kredituar me transfertë shuma prej 80.000 lekësh në datën 14.10.2014 dhe shuma prej 569.500 lekësh në datën 12.3.2015, me përshkrimin “pagesë nga \*\*\*, në cilësinë e përmbaruesit për zbatim vendim gjykate nr. \*\*\*, me debitor shtetasin A. I.”. Në po këto data, shumat përkatëse janë tërhequr *cash* nga shtetasja T. I.

Nga hetimi i lëvizjes së llogarisë bankare të shtetasës T. I. në “Raiffeisen Bank”<sup>45</sup> ka rezultuar se është kredituar me transfertë shuma 120.000 lekë në datën 23.3.2015, me përshkrimin “pagesë nga zyra përmbarimore Tiranë për pagesë detyrimi nga shtetasi A. I.”. Në po këtë datë, kjo shumë është tërhequr *cash* nga llogaria rrjedhëse nga shtetasja T. I.

**134.** Komisioni ka verifikuar të dhënat e mësipërme duke kërkuar informacion dhe kopje dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë<sup>46</sup> rezulton se nëna e subjektit të rivlerësimit, shtetasja T. I., ka qenë palë paditëse në çështjen civile nr. \*\*\* regj., me palë të paditur shtetasin A. I. dhe objekt “*Detyrimin për të më paguar vlerën e përdorimit të sendit të përbashkët në shumën 30.000 lekë/muaj. Detyrimin për të më lejuar të përdor sendin për banim*”. Nga përmbajtja e vendimit të gjykatës pasqyrohet aktekspertimi teknik i kësaj pasurie, nga ku është evidentuar se e gjithë prona përdoret nga i padituri A. I., i cili ka një sipërfaqe tepër nga pjesa takuese.

Gjykata pas shqyrtimit ka konkluduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 2.7.2007, pranimin e pjesshëm të kërkesës së ngritur nga paditësja T. I., detyrimin e të paditurit A. I. t’i paguajë shtetasës T. I. shpërblim për përdorimin e sendit të përbashkët në shumën 11.000 lekë/muaj, detyrimin e të paditurit A. I. të lejojë paditësen të përdorë disa ambiente nga prona në bashkëpronësi, si dhe ngarkimin e palës paditëse që të zgjidhë problemin e sistemit të ambienteve që do të përdori.

Kundër këtij vendimi është paraqitur ankim dhe Gjykata e Apelit ka vendosur me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.3.2019, pushimin e shqyrtimit të çështjes që i përket këtyre palëve. Kundër vendimit të Gjykatës së Apelit është bërë rekurs dhe aktet i janë dërguar Gjykatës së Lartë, e cila me vendimin nr. \*\*\*, datë 16.4.2014, ka vendosur mospranimin e rekursit të ushtruar nga pala e paditur A. I.

**135.** Kjo pasuri nuk është pjesë e deklaratës *Vetting* dhe Komisioni nuk ka gjetur të dhëna për ta lidhur atë me procesin e rivlerësimit të subjektit Erarbër Madhi.

### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e pasurisë**

**136.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht, si dhe ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht në deklaratën *Vetting* pasuritë e tij dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

<sup>44</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 17.9.2020.

<sup>45</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 9.9.2020.

<sup>46</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 24.2.2022.

**137.** Subjekti ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë së tij. Nga hetimi ka rezultuar se subjekti i rivlerësimit nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të tij. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi nuk vërtetohen shkaqet që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatoheshin parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**138.** Komisioni vlerëson të ndalet edhe në mungesën e burimeve financiare prej 313.323 lekësh. Referuar jurisprudencës së konsoliduar të Kolegjit të Posaçëm të Apelit<sup>47</sup>, kjo mungesë burimesh financiare nuk mund të konsiderohet si deklarim i pamjaftueshëm, sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

**139.** Për sa më sipër, trupi gjyqës vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**140.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi me anë të verifikimit të deklaratimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016.

Për këtë qëllim, DSIK-ja ka dërguar në Komision raportin<sup>48</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaratimit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaruara në deklaratën për kontrollin e figurës; si dhe (iii) nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera nga të cilat të mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimit të organizuar.

**141.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera në përputhje me pikën 2 të nenit 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit. Ky qëndrim nuk ka ndryshuar edhe pas përditësimit të raportit nga DSIK-ja<sup>49</sup>.

**142.** Komisioni kreu një hetim<sup>50</sup> të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetin të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara rishtazi nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer nga Komisioni, edhe pas përditësimit të informacionit nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e tij në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

## **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

<sup>47</sup> Vendimet nr. 24/2021, nr. 38/2021, nr. 17/2022 dhe nr. 27/2022.

<sup>48</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2017, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 6.1.2021, të KDZH-së.

<sup>49</sup> Raporti i përditësuar me nr. \*\*\* prot., datë 23.6.2022, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. \*\*\* , datë 25.8.2022, të KDZH-së.

<sup>50</sup> Shihni dosjen me informacion të klasifikuar të subjektit të rivlerësimit.

**143.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

### **C. VLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE**

**144.** Vlerësimi i aftësive profesionale nga Komisioni është bazuar në:

- raportin për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit të kryer nga KLGJ-ja;
- kriteret e vlerësimit të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
- denoncimet e paraqitura në Komision.

#### **Raporti i hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor**

**145.** Ky raport është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, që kryhet nga institucionet e rivlerësimit në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**146.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; (ii) pesë dosjeve gjyqësore të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave nga burimet arkivore të KLGJ-së.

**147.** Raporti ka analizuar të dhënat e rezultuara nga dokumentet, duke iu referuar kriterëve të vlerësimit: (a) aftësitë profesionale; (b) aftësitë organizative; (c) etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale; si dhe (ç) aftësitë personale dhe angazhimi profesional.

**148.** Nga verifikimi i tri dokumenteve ligjore të depozituara nga subjekti dhe pesë dosjeve të përzgjedhura me short nuk u konstatuan problematika.

#### **Të dhëna mbi ankesat/masat disiplinore dhe kallëzimet**

**149.** Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë konfirmon<sup>51</sup> se nga verifikimi i kryer figuron të jetë regjistruar procedimi penal nr. \*\*\*, ku përmendet subjekti i rivlerësimit Erarbër Madhi, procedim ky i cili është pushuar në datën 21.11.2016.

**149.1** Nga shqyrtimi i dokumentacionit të disponuar rezulton se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë bazuar në germën “f”, pika 1 e nenit 328 të Kodit të Procedurës Penale ka vendosur në datën 21.11.2016 pushimin e procedimit penal nr. \*\*\*, viti 2016, me palë kallëzuese shtetasin A. B. për veprën penale “falsifikim dokumentesh”, parashikuar nga neni 186 i Kodit Penal.

**149.2** Nga përmbajtja e këtij vendimi rezulton se shtetasi A. B. ka qenë palë kallëzuese në tri kallëzime penale të depozituara në prokurori lidhur me pretendimin e falsifikimit të aktit të

---

<sup>51</sup> Shihni praktikën e përcjellë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.12.2020.

shitjes dhe vërtetimit të pronësisë së një pasurie me vendndodhje në \*\*\*, e cila sipas tij është përfituar padrejtësisht nga shtetasi A. H.

**149.3** Lidhur me historikun e këtyre kallëzimeve figuron se me kallëzimin nr. \*\*\*, datë 25.11.2011, nga ana e këtij shtetasi është pretenduar se subjekti i rivlerësimit, me vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 18.7.2011, ka favorizuar shtetasin A. H., duke e njohur pronar me parashkrim fitues mbi një shtëpi me sip. 90 m<sup>2</sup> dhe tokë me sip. 2000 m<sup>2</sup> në \*\*\*, Vlorë. Këto kallëzime janë shqyrtuar më herët nga prokuroria, e cila ka konkluduar në datën 24.7.2012 për mungesën e përgjegjësisë së gjyqtarit Erarbër Madhi si shkak i moskompetencës ligjore për të vlerësuar vendimet e gjykatës.

**149.4** Por nga ana e palës kallëzuese është paraqitur ankim në Prokurorinë e Përgjithshme mbi vendimmarrjen e Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë dhe, për rrjedhojë, është regjistruar procedimi penal nr. \*\*. Në vendimin e pushimit të këtij procedimi penal datë 21.11.2016 prokurori i çështjes ka konkluduar se në ngarkim të shtetasve të kallëzuar, ndër ta edhe subjekti i rivlerësimit, konstatohet se prokuroria nuk i ka atribuuar ndonjë vepër penale dhe as e ka gjetur përgjegjës, pavarësisht faktit se nuk është shprehur në ndonjë akt të posaçëm.

**150.** Sipas të dhënave të regjistrit të procedimeve disiplinore, për gjyqtarin Erarbër Madhi, përgjatë periudhës së rivlerësimit, nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

## **DENONCIME**

**151.** Në Komision janë paraqitur 18 denoncime, 15 prej tyre i drejtohen subjektit të rivlerësimit si gjyqtar, të tjerat i drejtohen disa subjekteve. Në lidhje me këto denoncime Komisioni vetëm për dy prej tyre ka konstatuar problematika.

**152. Denoncim i shtetasit A. F.,** i cili pretendon se subjekti i rivlerësimit ka zhvilluar një gjykim jo të rregullt me palë paditëse një person të vdekur, duke dhënë një vendim në kundërshtim me ligjin. Sipas denoncuesit, subjekti i rivlerësimit ka vendosur pa të drejtë dhe me dokumente false përvetësimin e pronave trashëgimore të gjyshit të tij J. S. vetëm në favor të njërit prej trashëgimtarëve ligjorë, shtetasit V. S., duke i hequr të drejtën e njohjes si bashkëpronarë trashëgimtarëve të tjerë ligjorë në pasurinë truall prej 10.4 hektarë.

**152.1** Nga investigimi në internet Komisioni është vënë në dijeni mbi disa të dhëna të marra nga portalet mediatike: [https://www.cna.al\\*\\*\\*](https://www.cna.al***), sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka gjykuar një çështje gjyqësore me paditës një shtetas që kishte ndërruar jetë.

**152.2** Lidhur me këto të dhëna Komisioni kërkoi informacion dhe kopje dokumentacioni nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë.

**152.3** Nga verifikimi i akteve të vëna në dispozicion nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Vlorë<sup>52</sup> rezultoi vendimi nr. \*\*\*, datë 27.9.2010, me palë paditëse shtetasin J. S., palë të paditur Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, person i tretë Bashkia Himarë, me objekt “kundërshtim i refuzimit të nxjerrjes së aktit administrativ, njohjen dhe kthimin në natyrë të disa sipërfaqeve tokë bujqësore”. Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar në përfundim të gjyqimit me pranimin e kërkesëpadisë, duke njohur dhe kthyer në natyrë trashëgimtarëve të të ndjerit V.

---

<sup>52</sup> Shihni shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.5.2022.



S. një sipërfaqe toke kullotë. Kundër këtij vendimi nuk është paraqitur ankim dhe ka marrë formë të prerë në datën 25.11.2010.

**152.4** Nga fashikulli i gjykimit figuron se kërkesëpadia me palë paditëse shtetasin V. S. është depozituar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Vlorë më 8.12.2009 dhe po në këtë datë është shortuar në sistem. Subjekti i rivlerësimit ka caktuar zhvillimin e seancës përgatitore në datën 23.12.2009, por kjo seancë është shtyrë duke u caktuar data e ardhshme 22.1.2010.

**152.5** Nga procesverbali i seancës gjyqësore të datës 22.1.2010 evidentohet se pala paditëse V. S. është thirrur, por nuk është paraqitur për shkak se në fletëthirrje rezulton shënimi që nuk ndodhet në Dhërmë. Gjykata ka vendosur të shtyjë seancën gjyqësore me qëllim përsëritjen e njoftimit për palën paditëse dhe palën e paditur.

**152.6** Sipas procesverbalit të seancës së radhës gjyqësore datë 8.2.2010 është paraqitur shtetasi J. S., trashëgimtar i shtetasit V. S., i përfaqësuar nga av. E. Th.. Nga ana e përfaqësueses është kërkuar suksesim procedural në rrethanat kur shtetasi V. S. ka ndërruar jetë, duke u paraqitur në këtë çështje si palë paditëse shtetasi J. S. Pjesë e akteve në dosje është edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 24.12.2008, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, me palë kërkuese shtetasin J. S. për lëshimin e trashëgimisë ligjore për trashëgimlënësin V. S., i cili ka ndërruar jetë në datën 1.12.2007.

**152.7** Nga shqyrtimi i përmbajtjes së vendimit rezulton se ndër aktet e paraqitura si prova nga pala paditëse në gjykatë është edhe vendimi nr. \*\*\*, datë 10.5.2002, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë për pranimin e kërkesës së shtetasit V. S., duke e njohur pronar mbi 13 hektarë tokë kullotë, si dhe ka vendosur në afat kërkesën e këtij shtetasi për njohjen e pronësisë. Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se nga provat në gjykim u njihet pronësia trashëgimtarëve të të ndjerit V. S.

**152.8** Në vlerësim të kësaj situate, gjyqtari në fazën e veprimeve përgatitore verifikon legjitimitetin e palëve në respektim të përcaktimeve të Kodit të Procedurës Civile. Në rastin konkret, në momentin e paraqitjes së kërkesës për suksesim subjekti i rivlerësimit duhet të verifikonte faktin e vdekjes së palës paditëse, që rezulton në një periudhë kohore më të hershme se viti 2009 kur është depozituar kërkesëpadia në emër të shtetasit V. S., si dhe autenticitetin e firmës. Për rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit duhet të dispononte me vendimin për mospranimin e kërkesëpadiës, në kushtet kur palës paditëse i mungonte legjitimiteti për ta paraqitur atë.

Kërkesa për suksesim procedural është pranuar nga subjekti i rivlerësimit në aplikim të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se kur njëra nga palët vdes çështja vazhdon nga/ose kundër trashëgimtarëve të saj. Ky interpretim duket i vlefshëm në rastet kur pala ndërron jetë gjatë procesit gjyqësor dhe nuk ka lidhje me legjitimitetin e palëve kërkuese në gjykim. Po ashtu, mbetet i paprovuar se cili ka përgatitur/firmosur padinë dhe depozituar atë në gjykatë.

Duket se subjekti i rivlerësimit ka vijuar gjykimin e kësaj çështjeje në interpretim të gabuar të legjislacionit në fuqi.

**152.9** Pas kalimit të barrës së provës subjekti parashtroi: *“Shpesh në praktikën e përditshme të punës, gjatë gjykimit të padive me natyrë administrative, konstatohet se për shkak të mosnjohjes së mirë të ligjit nga ana e subjekteve palë paditëse, ato ushtrojnë kërkesëpaditë, duke i ndërtuar ato gabim nga pikëpamja procedurale. Gjate gjykimit të padive me palë të paditur Agjencia e*

*Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me objekt 'kundërshtim i refuzimit të nxjerrjes së aktit administrativ, njohjen dhe kthimin në natyrë të disa sipërfaqeve tokë bujqësore', vihet re në praktikë se shpesh subjektet e ushtronin padinë në emër të subjektit ish-pronar në emër të të cilit kanë aplikuar pranë Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronave, ndërkohë që kërkesëpadia duhet të ushtrohej në emër të trashëgimtarëve ligjore të të ndjerit në rastet kur ai si në rastin konkret mund të kishte ndërruar jetë. Në këtë situatë procedurale dhe për të mos penguar aksesin e qytetarëve në dhënien e drejtësisë dhe për të mos shkaktuar humbjen e të drejtës së tyre për t'iu drejtuar gjykatës për shkak të mosnjohjes nga ana e tyre të ligjit, në praktikën e përditshme të punës, personalisht jam përpjekur të favorizoj dhënien e drejtësisë. Prandaj, në rastin konkret, kam aplikuar pranimin e kërkesës për suksesim procedural në aplikim të nenit 199 të Kodit të Procedurës Civile, ku parashikohet se kur njëra nga palët vdes, çështja vazhdon nga/ose kundër trashëgimtarëve të saj, duke u zëvendësuar proceduralisht pala paditëse që rezultonte të kishte ndërruar jetë me trashëgimtarin e tij ligjor. Në rastin konkret, pavarësisht faktit se ky interpretim mund të duket i vlefshëm në rastet kur pala ndërron jetë gjatë procesit gjyqësor, ishte i vetmi mjet procedural për të rregulluar ndër-gjyqësinë dhe legjitimitetin e palëve në gjykim. Me vendimin përfundimtar gjykata ka proceduar me gjykimin e padisë mbi bazë të provave të paraqitura për gjykim nga palët dhe ka vendosur se nga provat në gjykim u njihet pronësia trashëgimtarëve të të ndjerit V. S., duke mos përjashtuar asnjë nga trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit nga përfitimi i kësaj pasurie të trashëgimtarëve. Mospranimi i kërkesëpadisë si vendimmarrje që duhet të ishte marrë nga gjykata në këtë rast, që citohet në konstatimet e bëra nga Komisioni, është një nocion që u përfshi në kuadrin ligjor në nenin 39 të ligjit nr. 49/2012, 'Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative, të ndryshuar, dhe që hyri në fuqi vetëm në nëntor të vitit 2013. Në periudhën përkatëse, i vetmi mjet që kishte gjykata do të kishte qenë kthimi i kërkesëpadisë me të meta, por siç pasqyrova më lart, kjo do të sillte humbjen e afatit për të gjithë trashëgimtarët ligjorë të të ndjerit dhe nuk është aplikuar në rastin konkret pikërisht në kuadër të mospenalizimit dhe humbjes së afateve përkatëse për t'iu drejtuar gjykatës te një subjekt që kishte aplikuar pranë Agjencisë së Kthimit të Pronave dhe në mosnjohje të ligjit kishte ushtruar kërkesëpadinë në emër të subjektit ish-pronar.*

*Gjithsesi, më rezulton se kjo vendimmarrje gjyqësore i është nënshtruar rrugës së ankimit dhe rezulton të jetë lënë në fuqi edhe në fazën e ankimit në gjykatat më të larta”.*

**152.10** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse në kuptim të logjikës së ndjekur nga ana e subjektit në zgjidhjen e konfliktit gjyqësor, por nga ana tjetër subjekti nuk ka vepruar në përputhje me parashikimet ligjore të Kodit të Procedurës Civile. Në përfundim, Komisioni, pasi analizoi kushtet dhe rrethanat, veprimet e subjektit, si dhe pasojat e ardhura, çmon se nuk gjendet përpara shkeljeve që e bëjnë magjistratin të papërshtatshëm për të ushtruar funksionin e saj si magjistrat.

**153. Denoncimi i shtetasit I. A.,** i cili denoncon subjektin e rivlerësimit dhe një subjekt tjetër.

**153.1** Referuar akteve të denoncimit rezulton se shtetasi I. A. ka qenë palë paditëse në procesin gjyqësor të zhvilluar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me palë të paditur Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes (AISM), me objekt “shpërblim dëmi” që rrjedh nga marrëdhënia e punës dhe “dëmshpërblim page për zgjidhje të pajustificuar të kontratës së punës”. Gjykata ka konkluduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, për pranimin

pjesërisht të objektit të gjykimit dhe detyrimin e palës së paditur për të dëmshpërblyer palën paditëse.

**153.2** Sipas dokumentacionit të paraqitur nga denoncuesi rezulton se subjekti i rivlerësimit ka shqyrtuar çështjen datë regjistri 22.6.2015, me palë kërkuese Agjencinë e Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes me objekt “rivendosje e afatit lidhur me ankimin ndaj vendimit nr. \*\*\* datë 3.4.2015”. Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar me vendimin nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, për pranimin e kërkesës. Gjatë gjykimit ka rezultuar se për vendimmarrjen e themelit nr. \*\*\*, datë 3.4.2015, palët ndërgjyqësore kanë marrë dijeni në datën 23.4.2015 dhe ankimi nga AISM-i është ushtruar me shkresën e datës 4.5.2015 dhe nisur me postë më 5.5.2015, por ky dokument i është dërguar gabimisht Gjykatës Administrative të Apelit, e cila ia ka përcjellë me postë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë në datën 15.5.2015. Pra, në referim të nenit 443 të Kodit të Procedurës Civile ankimi i AISM-it ka mbërritur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë 7 ditë pas përfundimit të afatit 15-ditor për ushtrimin e të drejtës së ankimit ndaj vendimit të themelit (23.4.2015 - 8.5.2015).

**153.3** Subjekti i rivlerësimit ka vlerësuar se në aplikim të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile<sup>53</sup> kërkuesi AISM duhet të rivendoset në afat për paraqitjen e ankimit, pasi afati nuk është humbur asnjëherë prej palës kërkuese, e cila e ka ushtruar efektivisht.

**153.4** Kundër vendimit të dhënë nga subjekti i rivlerësimit ka paraqitur ankim në Gjykatën Administrative të Apelit shtetasi I. A. Në përfundim të gjykimit, Gjykata Administrative e Apelit ka konkluduar për prishjen e vendimit nr. \*\*\*, datë 21.7.2015, të dhënë nga subjekti i rivlerësimit.

**153.5** Gjatë gjykimit Gjykata Administrative e Apelit ka vlerësuar se në zbatim të nenit 149 të Kodit të Procedurës Civile<sup>54</sup> si datë e paraqitjes së ankimit të bërë nga AISM-i do të konsiderohet data 5.5.2013 kur është dërguar me postë. Pra, ky ankim kundër vendimit të themelit është paraqitur brenda afateve ligjore. Për rrjedhojë, gjatë shqyrtimit të kërkesës me objekt “rivendosjeje në afat” Gjykata Administrative e Shkallës së Parë, duke vlerësuar paraqitjen brenda afateve, duhet të vendoste për mospranimin, pasi është në rastin e ngritjes së një kërkitimi që nuk mund të ngrihej.

Në përfundim, subjektit iu kërkuan shpjegime pasi dukej se në gjykimin e çështjes me objekt rivendosjeje nuk i është referuar përcaktimeve ligjore në nenin 149 të Kodit të Procedurës Civile.

**153.6** Pas dërgimit të rezultateve të hetimit subjekti parashtroi se: *“Gjykata në rastin konkret ka vepruar dhe zbatuar drejt ligjin në aplikim të nenit 458 të Kodit të Procedurës Civile, duke vlerësuar se kërkuesi AISM duhet të rivendosej në afat për paraqitjen e ankimit, pasi afati nuk ishte humbur asnjëherë prej palës ankuese, e cila e ka ushtruar efektivisht.*

*Në rastin konkret rezulton se ankimi i palës së paditur AISM është depozituar me anë të postës në datën 5.5.2015, ndërkohë që kjo palë kishte marrë dijeni për vendimin e arsyetuar në datën 23.4.2015.*

---

<sup>53</sup> Neni 458 parashikon: *“Kur palët kanë humbur të drejtën e ankimit për shkak të arsyeshme mund të paraqesin kërkesë për rivendosje në afat, përpara gjykatës që ka dhënë vendimin”.*

<sup>54</sup> Neni 149/2 parashikon: *“Afati nuk quhet i humbur kur kërkesa ose akti është dërguar me postë edhe në ditën e fundit të afatit”.*

*Pra, ankimi rezulton të jetë depozituar në ditën e dymbëdhjetë, pasi dita e marrjes dijeni nuk përlllogaritet në rastin e ushtrimit të ankimit dhe, për pasojë, e ka ushtruar ankimin brenda afatit 15-ditor të parashikuar nga ligji. Për pasojë, pala ankuese e ka ushtruar ankimin në afat pavarësisht se në mënyrë të gabuar e ka dërguar me postë drejtpërdrejt në Gjykatën Administrative të Apelit, ndërkohë që duhet ta kishte dërguar pranë Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë”.*

**153.7** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, vlerëson se ato janë bindëse, pavarësisht faktit se vendimmarrja e tij është cenuar nga ana e një gjykate më të lartë, vendimmarrje e cila i përket themelit të çështjes. Në këtë vendimmarrje është konstatuar se nga ana e subjektit nuk duhej të ishte vendosur rivendosje në afat, pasi, sikundër ka argumentuar edhe subjekti, afati i ankimit nuk kishte përfunduar. Për rrjedhojë, për sa kohë kjo vendimmarrje e subjektit nuk ka cenuar të drejtat e palëve dhe zgjidhja është e njëjtë, Komisioni vlerëson se nuk gjendet përpara mangësisë profesionale, në kuptim të indikatorëve të parashikuar nga ligji nr. 96/2016.

### **Konkluzion i Komisionit për vlerësimin e aftësive profesionale**

**154.** Pas shqyrtimit të raportit të hartuar nga KLGJ-ja, denoncimeve të depozituara në Komision dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si më sipër, trupi gjykues vëren se nuk mund të ngrihen dyshime për paaftësi profesionale apo cilësi që cenojnë figurën e gjyqtarit.

**155.** Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve, është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme dhe konsiderohet “i aftë” në aspektin profesional.

**156.** Për sa më sipër, trupi gjykues arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka arritur një nivel të mirë kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **KONKLUZION PËRFUNDIMTAR**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatores së çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se subjekti:

- i. arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- ii. arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- iii. ka një nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

## **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, me shumicë votash,

## **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit Erarbër Madhi, gjyqtar në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë.
  2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
  3. Ky vendim ankimohet pranë Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar.
  4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
- U shpall në Tiranë, në datën 13.2.2023.

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Lulzim HAMITAJ**  
**Kryesues**

**Genta TAFA (BUNGO)**  
**Anëtare**

**Valbona SANXHAKTARI**  
**Relatore**  
**(kundër)**

*Sekretare gjyqësore*  
*Jonida Vrana*